



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” në  
“Psikologji” me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji  
edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i  
organizatave, e. Marketing,  
i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i  
Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Asoc. Artemisi Shehu

2. PhD. Eglantina Dervishi

Janar/2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti European i Tiranës përbëhet nga 5 Fakultete, 11 Departamente dhe 4 qendra kërkimore. Njësia bazë që ofron programin e studimit është Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale. Njësia kryesore e mëparshme ka qenë "Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit", i cili është riorganizuar me Urdhër të MASR Nr. 528, datë 04.09.2018 në "Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale". Duke qënë se programi i studimit "Bachelor" në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing, i përket një fakulteti të riorganizuar, UET i është drejtuar Bordit të akreditimit me anë të shkresës Nr. 38 prot, datë 27.02.2019, "Mbi akreditimin Institucional të UET pas riorganizimit të Fakulteteve ekzistuese dhe hapjes së dy fakulteteve të reja". Shkresa e Bordit të akreditimit Nr. 1 prot, datë 15.03.2019, sugjeron UET disa opsione për vijimësinë e procesit. UET me anë të shkresës Nr. 38/2 prot, datë 11.04.2019, zgjedh të aplikojë për një proces të pjesshëm akreditimi me detyrim financiar të diferencës së tarifës së akreditimit të plotë të njësive të reja të hapura, por me afate që nuk do tejkalojnë ato të akreditimit aktual sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017. Universiteti European i Tiranës është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" është hapur me Urdhër Nr. 496, datë 07.10.2011 të MASH. Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Psikologji" është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013 bazuar në Vendimin Nr. 467, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. Ky program studimi është riorganizuar dhe përshtatur me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, datë 14.06.2018 dhe me Vendim Bordit të Administrimit Nr. 47/1, datë 21.06.2018 në "Bachelor" në "Psikologji" me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhimi i organizatave, e. Marketing. I realizuar me 180 kredite (ECTS), në formën e studimit me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në gjuhën shqipe, në në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Psikologji", me profile: Shëndet Mendor / Psikologji Edukimi / Marrëdhënie Publike / Menaxhimi i Organizatave / Marketing. Bazuar në shkresën kthim përgjigje drejtuar Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Nr. 8244/1, datë 12.09.2018 mbi "Kërkesën për miratimin e riorganizimit dhe përshtatjes së programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit" për programet e studimi të propozuara nga UET, shkresa konfirmon njohjen në masën 20% të ndryshimeve për këto programe. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore / integruese ku përfshihet ndarja në 5 profilet Shëndet Mendor / Psikologji Edukimi / Marrëdhënie Publike / Menaxhimi i Organizatave / Marketing, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit janë punimi i diplomës ose provimi i përgjithshëm përfundimtar. Për vitin akademik 2018 - 2019, jane gjithsej 122 studentë, për të tre vitet.



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Sikurse përmendet më sipër, programi “Bachelor” në “Psikologji”, është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013 bazuar në Vendimin Nr. 467, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit.

Ky raport synon të japë një analizë të përgjithshme, të bazuar në të gjitha gjetjet tona përgjatë realizimit të procesit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Psikologji”, me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Manaxhim i organizatave dhe e. Marketing, të Universitetit Europian të Tiranës. Ai përmbyllet me rubrikën e përfundimeve të vlerësimit ku identifikohen **Pikat e forta dhe afirmime, Pikat e dobëta** dhe **Rekomandime**.

*Kjo analizë do të nisë me marrjen në shqyrtim të rekomandimeve të përcaktuara në procesin e akreditimit të 2013.*

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Përmirësimin e cilësisë së ulët të studentëve të pranuar në programin BSc në Psikologji.
2. Realizimin e një njohje më të mirë të tregut për psikologë, bazuar në interesat e maturantëve dhe mendimet e Bordit të Tregut të Punës.
3. Integrimin e rezultateve të kërkimit në procesin mësimor.
4. Rritjen e numrit të pajisjeve teknologjike mësimore dhe burimet e literaturës në mbështetje të programit BSC në Psikologji.
5. Përfshirjen e studentëve në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, të mësimdhënies dhe të vlerësimit të brendshëm.
6. Përfshirjen e studentëve në veprimtarinë kërkimore të Departamentit të Edukimit, të FSHSE dhe të universitetit.

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Referuar dokumentacionit të ardhur nga institucioni si dhe takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në vend, sipas agjendës së përcaktuar, arrijmë në përfundimin se rekomandimet e lëna nga akreditimi i mëparshëm për programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”, i riorganizuar në masën nën 20% me profile: Shëndet Mendor / Psikologji Edukimi / Marrëdhënie Publike / Menaxhimi i Organizatave / Marketing, janë përbushur kryesisht.

**Rekomandimi 1.** *Përmirësimin e cilësisë së ulët të studentëve të pranuar në programin BSc në Psikologji.*



Studentët e pranuar në Programin Bachelor në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave dhe e. Marketing, hyjnë me mesatare 7.5. Kjo e fundit është realizuar në saj të udhëzimeve të MASR për këtë program studimi i cili paracakton notën mesatare që është detyrim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë publike e jopublike.

#### Rekomandimi 1 Përmbushet plotësisht

**Rekomandimi 2.** *Realizimin e një njohje më të mirë të tregut për psikologë, bazuar në interesat e maturantëve dhe mendimet e Bordit të Tregut të Punës.*

Nga konsultimi i dokumentacionit të dërguar dhe nga vizitat në institucion, rezulton se një pjesë e profileve të reja, vështirë tu përafrohen profileve të psikologjisë, në përputhje me standartet e Europiane (EuroPSy). Këtu i referohemi programit Bachelor në "Psikologji", me profile: Marrëdhënie publike apo Marketing dhe evidencave mbi numrin e studentëve që punojnë në profilin e tyre.

#### Rekomandimi 2 Përmbushet pjesërisht

**Rekomandimi 3.** *Integrimin e rezultateve të kërkimit në procesin mësimor.*

Duke iu referuar aspekteve që lidhen me lëvizjet e stafit dhe bazuar në rezultatet e pakta ose të munguara, në drejtim të kërkimit shkencor të stafit të ri, edhe në ato raste kur kishte gjurmë të kërkimit shkencor, këto kishin një mospërputhje me lëndën apo modulën që stafi mbulon në këtë program studimi.

#### Rekomandimi 3 Përmbushet pjesërisht

**Rekomandimi 4.** *Rritjen e numrit të pajisjeve teknologjike mësimore dhe burimet e literaturës në mbështetje të programit BSC në Psikologji.*

Aktivizimi i sistemit LMS për të rritur ndërveprimin dhe komunikimin midis stafit dhe studentit në kohë reale në funksion të kushteve që favorizojnë të nxënësit, si edhe aplikimi i UMIS, sistem për menaxhimin e të dhënave dhe rekordeve të institucionit në mbështetje të procesit mësimor.

Referuar literaturës që institucioni ka në dispozicion të këtij programi studimi me 5 profile, shumica e teksteve ishin të një botimi para vitit 2010, të një cilësie të dobët dhe me probleme serioze të përshtatjes në shqip (terminologjia e fushës nuk është përdorur në mënyrë korrekte nga përkthyesi). Vështirësi edhe në drejtim të gjetjes së teksteve që mbulojnë profilet e programit pas riorganizimit të tij dhe mos angazhimi i strukturave përkatëse në drejtim të pasurimit të literaturës së lëndëve/moduleve me tekste të reja për këtë vit akademik.

#### Rekomandimi 4 Përmbushet pjesërisht

**Rekomandimi 5.** *Përfshirjen e studentëve në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, të mësimdhënies dhe të vlerësimit të brendshëm.*


Nuk kemi prova për prezantimin e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit, mësimdhënies dhe vlerësimit të brendshëm tek studentët e programit. Por kemi hasur shqetësimin e disa prej studentëve në lidhje me riorganizimin e programit të studimit, lidhur me mospërfshirjen e tyre në këtë proces (referuar vizitës në institucion).

**Rekomandimi 5 Përbushet pjesërisht**

**Rekomandimi 6.** *Përfshirjen e studentëve në veprimtarinë kërkimore të Departamentit të Edukimit, të FSHSE dhe të universitetit.*

Mungesa e përfshirjes së studentëve të këtij programi studimi në veprimtarinë kërkimore, në rang departamenti, fakulteti apo universiteti. Ky është një aspekt i rëndësishëm për të mbështetur dhe orientuar studentët në avancimim e tyre në drejtim të zhvillimit të dijeve të reja, shprehive, teknikave dhe kompetencave profesionale që lidhen me figurën e psikologut. Përfshirja e lartë e studentëve në këtë proces ndikon pozitivisht në aftësinë e tyre të të mësuarit dhe bën të mundur, që ata të ndihen emocionalisht të lidhur dhe të kënaqur me programin e tyre të studimit dhe institucionin.

**Rekomandimi 6 Nuk përbushet**



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit “Bachelor” në “Psikologji”, me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër Nr. 83, datë 16.10.2019 të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti Europian i Tiranës“. Grupi i vlerësimin të jashtëm i përbërë nga Prof Asoc. Artemisi Shehu drejtuese e grupit), PhD. Eglantina Dervishi (anëtare), Msc. Emisa Isufaj (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon UET-in, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit përmbush standardet. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi optimal të të nxënimit për studentët.

Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit; Studentët dhe Mbështetja e Tyre; Sigurimi i Cilësisë së Programi. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit.

Më datë 08.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 9/1 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 14.01.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë Nr. 06/2, datë 15.01.2020, dërgohet përgjigja e Institucionit në lidhje me draft - Raportin, “Komente në lidhje me Draft raportin e GVJ për programin Bachelor Psikologji”.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi draft-Raportin të paraqitura sipas fushave, shprehet si vijon:

- Lidhur me komentin që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “Realizimin e një njohje më të mirë të tregut për psikologë, bazuar në interesat e maturanëve dhe mendimet e Bordit të Tregut të Punës”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Një pjesë e profileve të reja, vështirë t'iu përafrohen profileve të psikologjisë, në përputhje me standartet e Europiane (EuroPSy)<sup>1</sup>. Këtu i referohemi programit Bachelor në "Psikologji", me profile: Marrëdhënie publike apo Marketing dhe evidencave mbi numrin e studentëve që punojnë në profilin e tyre. Gjithashtu, bazuar në vizitën në institucion nga takimi me studentët kishte pakënaqësi lidhur me mospërfshirjen e tyre në lidhje me ripërshtatjen e programit të studimit dhe profilizimi i tij që në vitin e parë. Studentët<sup>2</sup>, shprehën kërkesën për "pasurimin e kurrikullës me më shumë lëndë që vërtetë prekin psikologjinë" sic shprehet njëri prej tyre dhe miratohet edhe nga të tjerët të pranishëm në takim. Shqetësim tjetër i tyre lidhet me faktin se shumë lëndë që bëhen në auditore të përbashkëta me studentë që janë të programeve të tjera, për këtë aspekt kërkesa e tyre ishte që pedagogët "lëndët bazë duhet të mundohen t'i sjellin në kontekstin e psikologjisë" shprehet një tjetër student. Programi bachelor për dy profilet Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing, i cili sipas argumentit të ardhur nga institucioni shprehet se nuk ka si qëllim që t'iu mundësojë studentëve të niveli bachelor njohuri të thelluara të fushës së psikologjisë por të pajisë ato me aftësi të një fushe përtej psikologjisë, na shqetëson në lidhje me stabilitetin e tij në kohë. Programi bachelor nuk ka si qëllim të formësojë profile të ndërmjetme, dhe e theksojmë se profilet e ndërmjetme kanë logjike kur bëhen brenda profileve të përafërta. Por kjo e fundit është me e realizueshme në ciklin e dytë të studimeve, dhe kjo jo në të gjitha rastet lejohet ( ref. EUROPSY, fq 15. )Bazuar në Urdhrin e Psikologut, kriteret për licensim dhe ushtrimin e profesionit të lirë paracaktojnë që studentët të kenë mbaruar dy cikle studimi bachelor dhe master në fushën e psikologjisë<sup>3</sup>. Çdo lloj ndërthurje tjetër në profile të përafërta cënon të drejtën e studentëve për t'u licensuar. Nëse studentët do kishin interes për këto profile mund të orientoheshin drejt gazetarisë apo ekonomisë, pasi janë profile që përafrohen më shumë me këto dy fusha. Një tjetër shqetësim i cili forcon qëndrimin tonë lidhet me punësimin e studentëve në profilin e tyre, kjo duke iu referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga IAL-i<sup>4</sup>, ku numri i studentëve që kanë gjetur punë në profilin e tyre është i papërfillshëm, për vitin 2013 nga 10 të diplomuar në total, numri i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën është 0, dhe vijon 2014 në totali 12 student, 1 i punësuar dhe në këtë linjë vijon edhe për vitet e tjera ku ky numër arrin në 3 të punësuar brenda profilit në vitin 2017, nga 55 studentë të diplomuar. Është e rëndësishme që nga të gjitha strukturat që institucioni ka ngritur dhe ka në dispozicion të përshtatjes dhe adresimit efikas të gjetjeve nga fokus-grupet dhe pyetësorët me studentët, t'i vërë në shërbim të përmirësimit të programit të studimit me nevojat e tregut të punës.

<sup>1</sup> European Psychology Accreditation Council. (2019). Accreditation Standarts for Psychology Programs. Effective 1. January 2019. Version 1.2. pg- 15-26.

<sup>2</sup> Vizita në Institucioni. Dokumenti nr. 2. Minutat e takimeve- Bsc. Psikologji me 5 profile UET, faja 20, 22.

<sup>3</sup> Rregullore Për Regjistrimin, Anëtarësimin Dhe Liçencimin Në Urdhrin E Psikologut Të Republikës Së Shqipërisë. <https://www.urdhriipsikologut.al/up-content/uploads/2019/10/Rregullore-per-rregjistrimin-anetaresimin-dhe-licencimin.pdf>

<sup>4</sup> Vizita në Institucioni. Dokumenti nr. 6. Të dhënat për punësimi.

- Lidhur me komentin që bëhet për realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm “Integrimin e rezultateve të kërkimit në procesin mësimor”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Duke iu referuar aspekteve që lidhen me lëvizjet e stafit dhe bazuar në rezultatet e pakta ose të munguara, në drejtim të kërkimit shkencor të stafit të ri, edhe në ato raste kur kishte gjurmë të kërkimit shkencor, këto kishin një mospërputhje me lëndën apo modulën që stafi mbulon në këtë program studimi. Në dokumentacionin fillestar të dorëzuar në ASCAL nga IAL-i dhe të marrë në shqyrtim nga grupi i vlerësimit të jashtëm rezultoni disa pedagogë të tjera nga ato që gjetën gjatë vizitës në institucion. Pas një periudhe kohore institucioni ka dërguar një liste të stafit të angazhuar në mësimdhënie. Grupi i vlerësimit të jashtëm i është referuar pikërisht asaj liste<sup>5</sup>, ku një pjesë e stafit e përfshirë në përgjigjen e institucioni nuk janë më pjesë e tij, si E.M, H.H. Duke u bazuar tek stafi i rekrutuar në disa prej tyre nuk ka gjurmë të kërkimit shkencor<sup>6, 7, 8</sup>.*

- Lidhur me komentin që bëhet për realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm “Rritjen e numrit të paisjeve teknologjike mësimore dhe burimet e literaturës në mbështetje të programit Bsc në Psikologji”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Referuar literaturës që institucioni ka në dispozicion të këtij programi studimi me 5 profile, shumica e teksteve ishin të një botimi para vitit 2010, të një cilësie të dobët dhe me probleme serioze të përshtatjes në shqip (terminologjia e fushës nuk është përdorur në mënyrë korrekte nga përkthyesi). Vështirësi edhe në drejtim të gjetjes së teksteve që mbulojnë profilet e programit pas ripërshtatjes së tij dhe mos angazhimi i strukturave përkatëse në drejtim të pasurimit të literaturës së lëndëve/moduleve me tekste të reja për këtë vit akademik. Çdo institucion ka përgjegjësinë ligjore që të plotësojë të gjitha kushtet që lidhen me krijimin e infrastrukturës së nevojshme në drejtim të përmbushjes të kritereve që paracakton ligji për arsimin e lartë në drejtim të teksteve të detyruara në gjuhën shqipe për lëndët dhe modulet e programit të studimit që IAL-i ripërshtat. Argumenti i ardhur nga institucioni nuk justifikon mungesën e literaturës për lëndë kryesore të programit të studimit, sikundër merret në konsideratë kur IAL-i vendos ta pasurojë këtë program me profile të reja. Secili prej profileve të shtuara ka nevojë për literaturë të nevojshme në gjuhën shqipe që të mund të përvetësohet nga studenti. Komentet tona në lidhje me problemet në literaturë i bazojmë tek disa dokumente që UET ka dorëzuar në ASCAL<sup>9</sup> por edhe në vizitën në institucion<sup>10</sup>, ku i referohemi shqetësimit të sjellë nga student në lidhje me mungesën e librave, të cilët të jenë botime të fundit në fushën e psikologjisë dhe disa lëndëve të cilat nuk kanë literaturë në shqip dhe*

<sup>5</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr. 18. Stafi akademik I programit 2019-2020. .

<sup>6</sup> Dokumenti 24 vizita në institucion. A.H.

<sup>7</sup> Dokument 33,34, vizita në institucion. R.B., R.K.

<sup>8</sup> Dokument 27, 28,32, 26, vizita në institucion. B.A., B.A., M.S., B.L.

<sup>9</sup> Dokumenti 22 vizita në institucion. Fondi I Teksteve Psikologji

<sup>10</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr. 2. Minutat e takimeve- Bsc. Psikologji me 5 profile UET, faqja 21.



studentët detyrohen të mbështeten tek literature në gjuhë të huaj. I jemi referuar edhe takimit me pedagogët, të cilët janë angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit me 5 profile për vitin akademik 2019-2020, dhe ku asnjëri prej tyre nuk e ka parë të nevojshme rifreskimin e literaturës me libra të rinj<sup>11</sup>. Konstatimi ynë si grup vlersimi mbështetet tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekë<sup>12</sup> ku informohemi se për këtë vit akademik nuk është bërë asnjë blerje për Psikologjinë, dhe se pasurimi i bibliotekës bëhet përmes kërkesës së pedagogëve të cilët duhet të plotësojnë formularë në lidhje me titujt që duan të blejnë, dhe ku rezultoi se për këtë vit nuk kishte pasur asnjë kërkesë nga ana e stafit akademik. Në raport kemi vlersuar përpjekjen e UET në lidhje me aksesin në bibliotekat online si EBSCO & SAGE dhe COBISS Net, tek pikat e forta dhe afirmimet (faqja 54), si dhe i jemi referuar si element me ndikim pozitiv përgjatë raportit në disa fusha vlersimi (faqja 21, 22, 35).

Në lidhje me komentën e dhënë nga institucioni mbi literaturën për dy profilet e saj Marrëdhënie Publike dhe Marketing e cila ishte kategorizuar në fusha të tjera studimi jo tek fusha e psikologjisë<sup>13</sup>, përforcon më shumë argumentin tonë se këto dy profile i përafrohen fushave të tjera dhe mund të zhvillohen te departamentet përkatëse dhe jo si pjesë e fushës së psikologjisë.

- Lidhur me komentën që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “Përfshirjen e studentëve në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, të mësimdhënies dhe të vlerësimit të brendshëm”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Nuk kemi prova për prezantimin e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit, mësimdhënies dhe vlerësimit të brendshëm tek studentët e programit. Por kemi hasur shqetësimin e disa prej studentëve në lidhje me ripërshtatjein e programit të studimit, lidhur me mospërfshirjen e tyre në këtë proces. Rekomandimi i referohet jo hapësirës që UET i jep studentëve për t’u përfaqësuar në organe drejtuese të institucioni por në lidhje me detyrimin që ai ka në drejtim transparencës në lidhje me komunikimin e rezultateve për prezantimin e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe marrja e një feedback-u nga ana e tyre, prezantimi dhe diskutimi i rezultateve nga vlerësimi i pedagogëve që studentët bëjnë, ripërshtatjen e programit të studimit etj. I referohemi këtyre aspekteve, pasi vetë studentët gjatë vizitës në institucion e prezantuan para grupit të vlerësimit të jashtëm<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr. 2. Minutat e takimeve- Bsc. Psikologji me 5 profile UET, faqja 18.

<sup>12</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr. 2. Minutat e takimeve- Bsc. Psikologji me 5 profile UET, faqja 8.

<sup>13</sup> Përgjigja IAL- Bsc Psikologji 5 profile. Faqja 6.

<sup>14</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr. 2. Minutat e takimeve- Bsc. Psikologji me 5 profile UET, faqja 21, 22.

- Lidhur me komentin që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “Përfshirjen e studentëve në veprimtarinë kërkimore të Departamentit të Edukimit, të FSHSE dhe të universitetit”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Fillimisht vlen të theksohet se ky rekomandim është vendosur nga grupi i vlerësimit i cili ka kryer akreditimin e këtij programi studimi në 2013. Si i tillë duhet të ishte realizuar, apo nëse shihej i papërshtatshëm të ishte kundërshtuar nga ana e IAL-it. Duke qenë se ai është pjesë e rekomandimeve presupozohet që mund të realizohet. Ky është një aspekt i rëndësishëm për të mbështetur dhe orientuar studentët në avancimim e tyre në drejtim të zhvillimit të dijeve të reja, shprehive, teknikave dhe kompetencave profesionale që lidhen me figurën e psikologut. Përfshirja e lartë e studentëve në këtë proces ndikon pozitivisht në aftësinë e tyre të të mësuarit dhe bën të mundur, që ata të ndihen emocionalisht të lidhur dhe të motivuar për të avancuar në thellimin e njohurive në këtë program studimi. I referohemi dokumentit<sup>15</sup> të ardhur nga institucioni ku shpreheni specifikisht “Për vitin 2018-2019, nuk rezulton të kemi raste të studentëve të programit, që të jenë përfshirë në veprimtari të tilla”.

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin I.2, Kriteri 2 dhe 3; Standardin I.3, Kriteri 1 dhe 3 (Fusha I)**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Vihet re një tendencë për t'i përshtatur lëndët që janë pjesë e profileve, më tepër me linjën e programeve të tjera të studimit që UET ka të hapura, sesa me fushën e psikologjisë. Në këtë mënyrë kemi reduktim të kostove për institucionin në lidhje me mbulimin nga një pedagog, të leksioneve e seminareve për lëndë/module të përbashkëta me programet e tjera, por një politike e tillë ul ndjeshëm cilësinë në mësimdhënie dhe çënon të drejtën e studentit për arsim cilësor dhe konform fushës së zgjedhur dhe nuk i shërben objektivave formative të këtij programi studimi. Kujtojmë institucionin se profesioni i psikologut është një profesion i rregulluar me ligj dhe si i tillë kërkon plotësimin e disa kritereve specifike për të fituar të drejtën e licensimit dhe ushtrimit të profesionit. Asnjë student nuk dëshiron të humbas kohë dhe para në një program të cilin nuk synon ta kthej në profesion. Kjo nënkupton se studenti që nuk ka interes për fushën zgjedh një fushë tjetër studimi. IAL-i ka të gjitha resurset njerëzore për të ndihmuar studentin të bëjë një plan realist dhe objektiv për karrierën e tij profesionale.

- Lidhur me komentin që bëhet për vlerësimin e **Standardit II.2 (Fusha II)**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një përzierje të cikleve të studimit nga fusha të ndryshme ose është jashtë profilit të psikologjisë, ose nuk ka përvojë në mësimdhënie. Në këtë mënyrë rrezikohet mos zotërimi i kompetencave të mjaftueshme për njohje të thelluar të fushës së psikologjisë dhe që mund të përkthehet në paafësi për të disponuar asete që ndihmojnë zhvillimin e dijeve dhe kompetencave profesionale të studentëve. Shihet me skepticizëm, sesi një pedagog që nuk plotëson kushtet

<sup>15</sup> Vizita në Institucionin. Dokumenti nr.10. Sqarim për pikat 11,12,dhe 13, faqja 1.

për liçensim në Urdhrin e Psikologut, të ndihmojë studentin të formësojë njohuri dhe zhvillojë kompetenca që i japin mundësi të ushtrojë profesionin e psikologut. Fusha e kualifikimit të pedagogëve, jo në të gjitha rastet përkon me lëndët e profilet e këtij programi studimi. Për sa më sipër gjykojmë të rëndësishëm këto element, të cilët në rastin tuaj paraqesin mangësi.

- Lidhur me komentin që bëhet për vlerësimin e **Standardit III.1 (Fusha III)**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Vlersimet periodike të ndërmarra nga institucioni pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore. Edhe pse strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë po përballen me sfida të mëdha pas riorganizimit dhe hapjes së programeve të reja duke hasur vështirësi në drejtim të fushave të reja me të cilat ju mungon përvoja, domosdoshmëria e trajnimit të stafit lidhur me njohjen dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, numri i reduktuar i punonjësve që drejtojnë zyrën e kurrikulës dhe cilësisë, janë problematika që kanë nevojë të adresohen shpejt nga ana e institucionit. I referohemi shqetësimit të shprehur nga vetë punonjësit e kësaj zyre<sup>16</sup> për sa paraqitet më sipër.*

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.3, Kriteri 5**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Vlersojmë si të rëndësishëm për këtë fushë infrastrukturën në drejtim të avancimit me të njëjtin ritëm si përsa i përket ripërshtatjes, shtimit të programeve të reja, por edhe të shtimit të burimeve njerëzore dhe strukturave të posaçme për mbarëvajtjen e punës. Mbingarkesa e stafit egzistues me role e detyra të reja çënon cilësinë e shërbimit të ofruar dhe dëmton performancën e punonjësit e mirqënien e tij psikologjike.*

- Lidhur me komentin që bëhet për vlerësimin e **Standardit III.3**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Referuar literaturës që institucioni ka në dispozicion të këtij programi studimi me 5 profile, shumica e teksteve ishin të një botimi para vitit 2010, të një cilësie të dobët dhe me probleme serioze të përshtatjes në shqip (terminologjia e fushës nuk është përdorur në mënyrë korrekte nga përkthyesi). Vështirësi edhe në drejtim të gjetjes së teksteve që mbulojnë profilet e programit pas ripërshtatjes të tij dhe mos angazhimi i strukturave përkatëse në drejtim të pasurimit të literaturës së lëndëve/moduleve me tekste të reja për këtë vit akademik krijon probleme.*

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin III.8, Kriteri 8 dhe 9**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

*Kjo formë e paraqitjes së diplomës duket se ofron paqartësi në dokumentacionin që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ndërsa përsa i përket aneksit të listës së notave sipas profileve të këtij*

<sup>16</sup> Dokumenti 2 vizita në institucion. Minutat e takimeve – Bsc Psikologji 5 profile, fq 24-26.

programi studimi, paraqitja është bërë duke respektuar ndarjen sipas profileve. Rekomandohet që institucioni të tregohet korrekt dhe të respektojë të drejtat e studentit përsa i përket transparencës në përcaktimin e qartë të dy dokumentave që vërtetojnë kualifikimin e kryer nga studentët. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin me të cilin programi ka marrë vendimin për ripërshatje të tij nga MASR. Duke qenë se ky program studimi është ripërshatur miratimi nga Q.SH.A. nuk është bërë akoma, në këto kushte kemi vakanca përsa i përket formatit final.

Nuk kuptohet qartë arsya e profilizimit nëse suplementi i diplomës nuk gjykohet i rëndësishëm të jepet i diferencuar sipas profileve të reja? Ndryshimi i emërimit të një programi studimi dhe përfshirjen e elementëve të rinj në të sic është profilizimi në 5-së të tilla, nuk justifikohet plotësisht me ndryshime në masën 20%.

- Lidhur me komentin që bëhet për vlerësimin e **Standardit IV.2 (Fusha IV)**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Duhet të vlersojmë si të rëndësishëm për këtë fushë infrastrukturën në drejtim të avancimit me të njëjtin ritëm si përsa i përket riorganizimit institucional, shtimit të programeve të reja, por edhe të shtimit të burimeve njerëzore dhe strukturave të posaçme për mbarëvajtjen e punës. Mbingarkesa e stafit egzistues me role e detyra të reja çënon cilësinë e shërbimit të ofruar dhe dëmton performancën e punonjësit e mirqënien e tij psikologjike.

- Lidhur me komentin që bëhet për **Standardin IV.2, Kriteri 5**, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Vlersësimi i këtij kriteri bazohet në bazën materiale që disponohej dhe komenti është dhënë duke pasur parasysh këtë fakt. Por kjo nuk nënkupton rezerva nga ana e komisionit për mosvënien në dispozicion.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË “PSIKOLOGJI”, ME PROFILE: A. “SHËNDET MENDOR”, B. “PSIKOLOGJI EDUKIMI”, C. “MARRËDHËNIE PUBLIKE”, D. “MENAXHIM I ORGANIZATAVE”, E. “MARKETING”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Gjatë vizitës në institucionin e Universitetit Europian të Tiranës, takimeve me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentin mësohet se institucioni zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin e tij brendshëm Nr. 90, datë 28.02.2017 <sup>17</sup> , si dhe rregulloren e UET e miratuar me vendim senati që mban datë 04.03.2019 <sup>18</sup> , të hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Kjo është evidentuar edhe në rregulloren e institucionit, si dhe atë të programit të studimit Bachelor me profile.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar edhe rregullores se programit mund të thuhet se, programi i studimit Bachelor <sup>19</sup> në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing. respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendëshme që synon ndërthurjen midis disiplinave të ndryshme të njëra-tjetra.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Evidentohet se program i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor dhe në përputhje me politikat e brendëshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Larmishmëria e profileve mund të shihen në përputhje me qëllimet dhe misionin e UET, si dhe dëshmi e propagandës promovuese në drejtim të zhvillimit të fushës së veprimtarisë.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni, si dhe më specifikisht përmes planit mësimor të këtij programi studimi, por edhe nga diskutimet me përgjegjësën e departamentit, mësohet se programi i studimit synon nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal të vendit në kuadrin e multidisiplinaritetit, por nga ana tjetër, mbetet e paqartë mënyra sesi, referuar formës sesi është ndërtuar programi në 5 profilizime <sup>20</sup> , të bëjë të mundur integrimin e dijeve në funksion të nevojave të vendit, risku

<sup>17</sup> Dokumenti 3. Statuti i UET.

<sup>18</sup> Dokumenti 7. Rregullore UET.

<sup>19</sup> Dokumenti 24. Ba Psikologji- Kurrikula e programit.

<sup>20</sup> Dokumenti 25. Ba Psikologji – Plani Mësimor.

	mbetet krijimi i një “hibridi”, i cili nuk arrin ta gjejë veten brenda fushës së studimit. Sigurisht që është një mënyrë e re e pamatur deri më tani, por brenda këtij risku mbetet edhe vlerësimi i mëpasshëm.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

**Standardi I.2**

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Vërehet nga shqyrtimi i dokumentacionit të shfletuar se programi i studimit është në harmoni të plotë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Ai gjithashtu shpalos më së miri strategjinë për zhvillimin e institucionit, në mënyrën sesi menaxhohen burimet njerëzore dhe të tjera burime që institucioni ka në dispozicion, në funksion reduktimit të kostove dhe rritjes së fitimit.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar statutit dhe rregullores së institucionit ka një ambicje të lartë në drejtim të zhvillimit të vullshëm inovativ në të gjitha drejtimit akademike, të cilat përthyhen në kontribut në drejtim të kërkimit shkencor dhe kontributit konkret në drejtim të zgjidhjes së problematikave sociale-ekonomike të vendit. Shihet pak e paqartë mënyra sesi programi i studimit i zhvillon në brendinë e tij këto ambicie. Referuar kjo tendencës për t'i bashkangjitur mbulimin e ekspertizës nga disiplina, të cilat jo në të gjitha rastet i gjejmë lehtësisht të përshtatura me kushtet që i paracaktohen këtij profili për t'u licensuar <sup>21</sup> ( i referohem këtu profileve Marrëdhënie publike, e Marketing, të cilat shihen si jo të lidhura drejtpërdrejt me degën e psikologjisë).
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe stategjisë së tij për zhvillim, por mbetet sfidë për institucionin mundësia e përputhjes së këtij programi studimi me programe të tjera si motra brenda dhe jashtë vendit (referuar Europsy <sup>22</sup> përsa i përket standarteve për unifikimin e programeve të psikologjisë ka një ngërç në orientimin e këtij programi të profilizuar studimi me një larmishmëri fushash, të cilat rrezikojnë të mos e lejojnë të konsolidohet brenda vetes fillimisht). Këtu mund t'i referohemi edhe Urdhrit të Psikologut për marrjen e licensës së Psikologut në përfundim të studimeve.

<sup>21</sup> Rregullore Për Regjistrimin, Anëtarësimin Dhe Liçencimin Në Urdhrit E Psikologut Të Republikës Së Shqipërisë. <https://www.urdhriipsikologut.al/ep-content/uploads/2019/10/Rregullore-per-rregjistrimin-anetaresimin-dhe-licencimin.pdf>

<sup>22</sup> Lunt I., Peiró J. P., Poortinga Y., Roe R. (2014) Standards and Quality in Education for Professional Psychologists; Hogrefe.

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

**Standardi I.3**

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit udhëhiqet nga parimi i multidisiplinaritetit dhe kjo shpaloet edhe në mënyrën sesi është hartuar program, por referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit të fushës e psikologjisë në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka paqartësi, si rezultat i konfuzionit me të cilin përballet studentit në vitin e parë përmes profilizimit me orientim në njërin prej profileve të ofruara pa u njohur mirë me fushën e studimit. Prirja për ta pasuruar programin me lëndë ndërdisiplinore duket se e largojnë nga objektivi i shkencës së psikologjisë dhe e orientojnë studentin drejt fushës ekonomike apo komunikimit dhe gazetarisë. Programi “Bachelor” në “Psikologji”, me profile, duhet parë si themelet e formimit profesional të studentit dhe për këtë është e rëndësishme një thellim në dije, njohuri e aftësi të përgjithshme që mbeten brenda shkencës së psikologjisë, kjo si parakusht për të lehtësuar orientimin e tij në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të lejojë më pas një profilizim në përputhje me prirjet, kompetencat dhe interesat profesionale të studentit, gjë të cilën programi parashikohet ta ketë të vështirë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka një politikë të tijën në lidhje me mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me studentët e tij, gjithashtu ka dhe të dhëna përse i përket punësimit<sup>23</sup> të studentëve të diplomuar nga ku rezulton një numër i vogël i atyre që punojnë në profilin e tyre. Në lidhje me studime të tregut të punës<sup>24</sup>, kemi një studim paraprak që synon të jap një panoramë të tregut për ripërshtatjen e programit. Studimi është bërë përmes focus-grupeve në bashkëpunim me tregun e punës. Studimi arrin në konkluzionin se pas ciklit të parë të studimeve, të diplomuarit mund të hyjnë direkt në tregun e punës me statusin e specialistit apo punonjësit për çështjet psiko-sociale në institucionet/organizatat të ndryshme, sipas studimit të tregut nga ana e njësisë bazë. Institucioni ka realizuar një aktivitet me Urdhrin e psikologut<sup>25</sup> në lidhje me kushtet dhe rregullat për rregullimin e profesionit të psikologut, por mbetet e paqartë nëse Urdhri i</p>

<sup>23</sup> Dokumenti 14 Vizita në institucion. Të dhëna për punësimin.

<sup>24</sup> Dokumenti 29. Studimi periodik i tregut Ba Psikologji, fq 4.

<sup>25</sup> Dokumenti 51. Takim me Presidenten e Urdhrin të psikologut.

	<p>Psikologut njih dhe jep mundësinë për licensim një diploma “Bachelor” me profil “Marrëdhënie publike” apo “Marketing”. Referuar kriterëve për licensim këto dy profile nuk përfshihen drejtpërdrejt në drejtimet e fushës së psikologjisë. Gjithashtu, për punësimin në profesion nevojitet licensimi i psikologut<sup>26</sup>, i cili mund të bëhet vetëm pas mbarimit të ciklit të dytë të studimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit i japin mundësinë studentit të zgjerojë dhe të përthejë njohuritë dhe aftësitë e tij/saj në një gamë të gjerë fushash, që nënkupton përfshirjen në programin Bachelor. Lëndët karakterizuese/integruese<sup>27</sup>, të cilat janë grupuar në profile të mund të jenë pjesë e lëndëve që studentët e ciklit të parë të studimeve i realizojnë (i referohemi atyre lëndëve që janë pjesë e disiplinës, pasi nëse shihet me vëmendje grupimi i lëndëve sipas profileve, disa prej tyre nuk kanë lidhje me psikologjinë) dhe në këtë mënyrë e kanë më të thjeshtë të gjykojnë dhe të kenë qartësi për profilet. Por mendojmë se është kufizuese orientimi drejt profilit që në vitin e parë të studimit. Profilizimit në këtë moment i humbet vlera pasi studenti nuk njih akoma mirë fushën e gjerë të studimit dhe aq më pak pastaj të ketë qartësinë të profilizohet. Grupimi i lëndëve me profile nuk shihet me përfitim në drejtim të rritjes së cilësisë në këtë program studimi. Shkathtësitë dhe kompetencat e tyre ka gjasa të jenë të limituara pjesërisht në drejtim të kërkesave të tregut të punës si rezultat i kufizimit të fushës së studimit sipas profilizimit, i cili i pengon në marrjen e njohurive të përgjithshme, çka kompromenton njohjen holistike të fushës së psikologjisë në programin “Bachelor” për disa nga profilet e saj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin</p>	<p>Institucioni kryesisht përmbush kushtet e përgjithshme në lidhje me kapacitetet<sup>28</sup>, burimet, përvojën për të ofruar programin e studimit kjo e përthyer në stafin e angazhuar<sup>29</sup> në këtë program studimi<sup>30</sup>,</p>

<sup>26</sup> Rregullore Për Regjistrimin, Anëtarësimin Dhe Liçencimin Në Urdhër E Psikologut Të Republikës Së Shqipërisë.  
<https://www.urdhriipsikologut.al/up-content/uploads/2019/10/Rregullore-per-rregjistrimin-anetaresimin-dhe-licencimin.pdf>

<sup>27</sup> Dokumenti 25. BA Psikologji - Plani mësimor.

<sup>28</sup> Dokumenti 14 vizita në institucion. Të dhëna për punësimin.

<sup>29</sup> Dokumenti 34. Të dhënat tabelore për personelin akademik të angazhuar në programin Bachelor.



e një programi studimi në një fushë të caktuar.	mjediset që ka në dispozicion për të si dhe të burimeve të tjera ndihmëse në mbështetje të programit të studimit, si literatura në gjuhën shqipe e 5 viteve të fundit, edhe pse do të sugjerohej të përditësohej dhe shtohet e pasurohet literature fizike me botime <sup>31</sup> për këtë program studimi. Por nuk u vu re nga dokumentacioni ndonjë përfshirje e studentëve të këtij programi në kërkimin shkencor <sup>32</sup> apo edhe projekte të tjera.			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë si dhe ripërshtatjet të fundit të institucionit.			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë <sup>33</sup> të institucionit përsa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë njësisë bazë të ketë mundësi në rritje për zhvillimin e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes	Brenda institucionit vërehet të ketë një hierarki të strukturuar <sup>34</sup> sipas hallkave, e cila monitoron përmes mekanizmave të saj mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik <sup>35</sup> dhe atij ndihmës <sup>36</sup> në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor për këtë program studimi. Kjo vërehet duke iu referuar edhe dokumentacionit të

<sup>30</sup> Dokumenti 18, vizita në institucion. Stafi akademik i programit 2019-2020.

<sup>31</sup> Dokumenti 22, vizita në institucion. Fondi i teksteve Psikologji.

<sup>32</sup> Dokumenti 10, vizita në institucion. Sqarim për pikat 11, 12, 13.

<sup>33</sup> Dokumenti 156. Strategjia për Sigurimin e Brendëshëm të Cilësisë 2017-2022.

<sup>34</sup> Dokumenti 8. Dokumenti mbi organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit.

<sup>35</sup> Dokumenti 9. Rregullore mësimore e programit Ba Psikologji.

<sup>36</sup> Dokumenti 14. Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë mësimore.

njësive e personelit, marrjes së përgjegjëseve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	vënë në dispozicion si Dokumenti mbi organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit, Rregullore mësimore e programit Ba Psikologji, me profile, apo edhe Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë mësimore.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimin <sup>37</sup> me institucione vendase <sup>38</sup> , dhe të huaja dhe është angazhuar në një sërë projektsh kërkimore <sup>39</sup> dhe në saj të tyre ka nxitur edhe mobilitetin e studentëve <sup>40</sup> dhe stafit akademik <sup>41</sup> përmes projekteve të Erasmus + në institucione të tjera ndërkombëtare. Të gjitha këto shihen si elementë që ndikojnë pozitivisht në drejtim të rritjes së cilësisë së procesit mësimor dhe avancimit në drejtim të kualifikimit të stafit akademik. Megjithatë, do të sugjerohej që këto marrëveshje të mund të orientohen dhe të shfrytëzohen më shumë në drejtim të praktikave mësimore, të cilat duhet të realizohen brenda parametrave normale, (i referohemi informacionit të marrë nga takimi me pedagogët lektorë të programit si dhe studentëve të programit të studimit, të cilët na referuan se praktika realizohej në auditor).
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Gjithashtu, vihet re një ndërlidhje e mirë e marrëveshjeve të bashkëpunimit me projektet kërkimore ku UET është partner <sup>42</sup> dhe pjesë e tyre, të cilat rrisin përfitimin e këtij programi studimi dhe nevojave të tij të shpalosura në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie, edhe pse në mënyrë indirekte. Njësia përgjegjëse ka të dhëna përse i përket mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes Erasmus+, gjë e cila është për t'u evidencuar si element pozitiv që ka përfitime në funksion të realizimit të këtij programi studimi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Në funksion të praktikës profesionale njësia bazë ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi <sup>43</sup> , por një handicap rezulton në mënyrën sesi organizohet praktika <sup>44</sup> në këtë program studimi. Duke qenë se praktika realizohet në auditor <sup>45</sup> rezikon të jetë jo e plotë mënyrë e formësimit të dijeve profesionale. Përvoja praktike në terrenin e punës nuk mund të realizohet në "kushte laboratorike" sado eficient të jenë institucioni apo njësia bazë në krijimin e kushteve ideale. Kjo praktikë pune çënon mundësinë e njohjes reale të mjediseve të ndryshme profesionale nga ana e studentit. E gjithë kjo problematikë përkthehet në pamundësi të studentit për të njohur rolin dhe detyrat e psikologut në terrene të ndryshme profesionale dhe që ndikon më tej në paqartësinë e studentit për të zgjedhur studimet master.

<sup>37</sup> Dokumenti 53. Raporti periodik I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<sup>38</sup> Dokumenti 42. Tabela përmbledhëse për institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale.

<sup>39</sup> Dokumenti 66. Projekte UET 2011-2018.

<sup>40</sup> Dokumenti 64. Shkëmbimi I studentëve.

<sup>41</sup> Dokumenti 65. Të dhënat mbi shkëmbimin e stafit.

<sup>42</sup> Dokumenti 162/163. Fisha e projektit ENCHASE/ Fisha e projektit QAinAL.

<sup>43</sup> Dokumenti 42. Tabela përmbledhëse për institucionet bashkëpunuese për praktikën profesionale 2018-2019.

<sup>44</sup> Dokumenti 43. Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale.

<sup>45</sup> Dokumenti 2 vizita në institucion. Minutat e takimeve- Bachelor Psikologji 5 profile UET, fq 16-17, 21-22.

<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga të dhënat e vëna në dispozicion, UET ofron trajnime me qëllim që të ndihmojë sa më tepër studentët për zhvillimin e aftësive të tyre profesionale. Trajnimet janë jo vetëm për studentët që vazhdojnë studimet, por edhe për ato që janë diplomuar, ka evidenca përsa i përket trajnimeve profesionale <sup>46</sup> për të cilat institucioni është i certifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për mësuesit mbështetës ku dhe është dokumentuar moduli “Aspekte zhvillimore në procesin e edukimit të fëmijës dhe adoleshentit”. Ka një sërë aktivitete të renditura si trajnime profesionale në funksion të njohjes së rolit të psikologut apo në mbështetje të kurrikulës mësimore të këtij programi studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<sup>46</sup> Dokumenti 45. Trajnimetë mëtejshme profesionale, për studentët e diplomuar.



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit është hartuar konform legjislacionit vendas <sup>47</sup> dhe duke respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas udhëzimeve të MASR. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike, ku çdo vit ka peshën e fitimit të 60 krediteve, dhe në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë lëshohet diploma Bachelor në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Ky program studimi ka një kurrikul <sup>48</sup> , e cila grupin e lëndëve ndërdisiplinore/integruese i ka ndarë në 5 profile duke zgjeruar gamën e njohurive rreth disa disiplinave të përafërta brenda profilit të shkencave shoqërore, por shqetësimi që ngrihet lidhet me faktin sesa këto njohuri të përgjithshme me pikprerje me disa disiplina të tjera si shkencat e ekonomisë apo gazetarisë dhe komunikimit të mund të plotësojnë dhe fuqizojnë me kompetenca të nevojshme profilin profesional të psikologut. Një tjetër shqetësim lidhet me faktin që duke e profilizuar studentin që në vitin e parë mund të rrezikohet që këtij të fundit t'i kufizohet e drejta për të marrë një dije të përgjithshme të thelluar për disiplinën e psikologjisë.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Ky program studimi ndërthur njohuri, të cilat janë të përgjithshme dhe prekin lidhjet e pikë takimet me disa disiplina të përafërta me të, kjo mund edhe të çënojë njohuritë e studentit për të demonstruar aftësi dhe kompetenca të thelluara të disiplinës së psikologjisë. Edhe pse nga institucioni ndiqen politika, të cilat synojnë të rrisin cilësinë në mësimdhënie dhe njohuri të përparuara në drejtim të zhvillimit të fushës edhe përmes kushtit të vënë titullarit të lëndës për përditësimin e literaturës së detyruar mësimore të 5 viteve të fundit, kjo politikë nuk mund të lexohet në të gjitha rastet si parakusht për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kjo vihet në dyshim edhe nga literatura që institucioni ka në dispozicion të disiplinës së psikologjisë, i cili paraqitet relativisht i varfër në drejtim të botimit të teksteve mësimore sipas profileve, të

<sup>47</sup> Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

<sup>48</sup> Dokumenti 24. Ba Psikologji – Kurrikula e Programit.

	publikuara nga UET për zhvillimin e këtij programi studimi (referuar gjendjes fizike të literaturës në bibliotekë).			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit zhvillon te studenti njohuri të zgjeruara në drejtim të orientimeve të tij të shumta përmes profilizimit të programit bachelor në disa fusha, por jo të gjitha fushat kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me shkencën e psikologjisë (i referohemi këtu Bachelor në "Psikologji", me profile Marrëdhënie publike, dhe Marketing) në këtë mënyrë ekziston risku që të devijojnë studentin nga fusha dhe të cungojnë shprehitë profesionale.			
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018) <sup>49</sup> , duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë <sup>50</sup> dhe urdhrave <sup>51</sup> duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi II.2

#### Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale si njësi kryesore e riorganizuar së fundmi strehon njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve. Mësohet nga takimi me përgjegjësin e Departamentit dhe antarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe	Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë" sipas propozimit të përgjegjës të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Prof. Asoc. Dr. E.M. (sipas RVB), por gjatë takimit u informuam se roli i

<sup>49</sup> Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

<sup>50</sup> Dokumenti 181. Ligji nr 802015 Për Arsimin e Lartë.

<sup>51</sup> Dokumenti 189. Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Për akreditimin e disa programeve të studimit në Ba, MSH, MP.

<p>praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>kordinatorit ishte i pambuluar si rezultat i lëvizjeve të personelit akademik përgjegjëse për këtë program studimi, në kohët e fundit. Informacioni mbi mbulimin e këtij roli na është paraqitur në formë zyrtare me vendim Nr.46, datë 11.11.2019<sup>52</sup>, pas parashtimit të kërkesës gjatë vizitës tonë në institucion. Ky rol tashmë mbulohet nga Dr. B.A., e cila është prurje e re e stafit me kohë të plotë, e angazhuar në mësimdhënie këtë vit akademik edhe në këtë program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Struktura akademike e paraqitur nga UET në dokumentat e dosjes së vetvlerësimit është konform detyrimeve ligjore dhe nënligjore, por gjatë vizitës u konstatua se një pjesë e personelit të brendshëm të njësisë bazë kishin lëvizur dhe kjo u evidentua dhe nga takimi i realizuar gjatë vizitës në institucion me stafin akademik. Informacioni i përditësuar në lidhje me stafin akademik ka ardhur në mënyrë formale me shkresë zyrtare<sup>53</sup> nga institucioni me 13.11.2019. Bazuar këtij programi studimi sugjerohet një rekrutim i stafit, i cili ka një profil të pastër në fushën e psikologjisë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Përsa i përket kualifikimit dhe titujve akademik përgjithësisht stafi përmbush kushtet bazë për tu angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Edhe pse në disa raste kishte një ndërthurje të fushave të kualifikimit, të cilat mund të çenojnë cilësinë e mësimdhënies, si në rastin e pedagoge E.M., kualifikimet e të cilës në nivel master e doktorature ishin në fushën e punës sociale. Departamenti sugjerohet të rishikojë përzgjedhjen e vijueshme në drejtim të përzgjedhjes së stafit akademik, i cili do angazhohet në mësimdhënie, kjo për të përmbushur cilësisht kriteret e nevojshme për të lektuar profesionalisht në këtë program studimi. Kandidatët nevojiten të kenë një profil të pastër në fushën e psikologjisë, sidomos për ata pedagogë që mbulonjnë lëndë të rëndësishme të formimit profilizues.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë. Në vitin akademik 2019-2020 në funksion të organizimit dhe strukturës akademike janë angazhuar 24 anëtarë të personelit akademik efektiv, nga të cilët 22 me grada dhe tituj. Ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv ka qenë në masën 93%, nga 70% referuar minimumit të kërkuar nga standardi i cilësisë. Kjo evidencë na lejon krijimin e një panorame të qartë të situatës për periudhën aktuale dhe projektimin e saj në vijimësinë e këtij programi studimi. Sugjerohet të tregohet kujdes në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve dhe llojit të profilit që mbulon secili pedagog.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<sup>52</sup> Dokumenti 13 vizitë në institucion. Vendimi për emërimin e koordinatorëve të programit.

<sup>53</sup> Dokumenti 18, vizita në institucion. Staf akademik i programit 2019-2020.

		<b>X</b>	
--	--	----------	--

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjës të departamentit dhe zyrat përkatëse të ZBNj apo edhe ZNjSBC mësohet se protokollet e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Ky program studimi është organizuar konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmblylëse.
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Përsa i përket përmbajtjes së planit mësimor ai është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respektimit të standarit për shpërndarjen e 60 krediteve në çdo vit akademik, një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmblylëse.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi i studimit Bachelor në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing <sup>54</sup> ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas viteve akademike.
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	UET ka një rregullore mësimore për programin e ciklit të parë të studimit mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit European të Tiranës. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës

<sup>54</sup> Dokumenti 9. Rregullore mësimore e programit BA Psikologji.

	të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij.			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve<sup>55</sup> sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi. Problematike shfaqet silabusi “Praktikës dhe zhvillim karriere”, e cila realizohet në auditor me tematika që jo domosdosmërisht ndihmon studentin të kuptoj dhe njohë më mirë rolin e psikologut në profile të ndryshme të fushës së psikologjisë, psh tematika XII Logopedia nuk shihet e lidhur shumë me fuqizimin e dijeve dhe kompetencave të psikologut, por me mënyrën sesi një logoped punon me fëmijët me autizëm, por ky program studimi nuk përgatit logoped, por psikolog, edhe pse vlerësohet të jetë pozitiv fakti që psikologu njohë rolin e kolegëve të tjerë që janë pjesë e ekipit multidisiplinar, do të sugjerohej që ai të njihej më mirë me rolin e tij në brendi të këtij ekipi. Nga ana tjetër, përgjatë tematikave ndeshen edhe aspekte të tjera që bëhen shkas për konfuzion të studentit, i refrohemi tematikës mbi rolin e psikologut klinik në gjykatë, psikologu klinik mund të punojë në gjykatë nëse ka një kualifikim në fushën e psikologjisë ligjore referuar urdhërimit të ministrisë së drejtësisë dhe urdhrat të psikologut, ky profesion tashmë është rregulluar.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përsa i përket programit të studimit të Bachelorit në “Psikologji” me profile, përmirësimit dhe përditësimi i vazhdueshëm, theksohet se ky program është ripërshtatur së fundmi me qëllim përmirësimit të tij. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë. Në linjë me profilizimin sugjerohet që pedagogët që mbulojnë lëndët karakterizuese të programit, të kenë një vijimësi në të dyja apo trija ciklet e studimit brenda profilit të psikologjisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<sup>55</sup> Dokumenti 31. Formatit i Silabusit Cikli i parë dhe i dytë.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 180 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 3 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit European të Tiranës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing mund të krijoj vështirësi në drejtim të njohurive, aftësive, licensimit dhe punësimit për dy profilet e tij Marrëdhënie publike, Marketing, pasi është e vështirë të arrihet një profilizim që të jep mundësi të punosh brenda fushës së psikologjisë. Shpërndarja e lëndëve i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë dhe disiplina të përafërta me to dhe janë brenda profilit të madh të shkencave shoqërore, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit dhe tematikave që prek, referuar silabusit të lëndës nuk të japin mundësi për qartësi brenda fushës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>Lëndët kanë një shpërndarje në semestra që respekton kuadrin ligjor përsa i përket vlerësimit në kredite dhe orëve mësimore, por aftësimi profesional duhet parë në vijim, referuar objektivave formuese të programit, i cili prezanton një ambicie për ta përfshirë psikologun në disiplina të përafërta përmes njohurive në drejtime të tjera si marrëdhënia me publikun, marketingun, komunikimin.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre refruar Europsy (European Certificate in Psychology)<sup>56</sup> paracakton se gjatë fazës së parë të studimit mund të përfshihen lëndë të rezervuara metodologjisë dhe teorisë jo të psikologjisë (psh filozofia dhe sociologjia), por kjo konsiderohet e rëndësishme për disiplinën e psikologjisë, pasi shkenca e psikologjisë përgjatë rrugës së zhvillimit të saj është mbështetur në këto dy disiplina për t'u zhvilluar, arsyja pse kurrikulla e psikologjisë përfshin lëndë të tjera bazë nga profile të përafërta bëhet me qëllim që të balancohet njohuria e mjaftueshme e studentit në lidhje zhvillimin e dijeve, kompetencave në drejtim të studimit të individëve, grupeve dhe shoqërisë. Por një sërë lëndësh si “Hyrje në ekonomi”, “E folur në publik”, E drejtë Familjare”; “Hyrje në analizën e ligjërimit”; Komunikim ndërkulturor”; “Marrëdhënie publike”; “Praktikum i zyrës së shtypit”; “Shkrim raportim lajmi”; “Hyrje në menaxhim”; “Hyrje në menaxhimin e operacioneve”; “Parimet e shpërndarjes së shitjes”; “Hartim dhe menaxhim projektësh” nuk i lejojnë studentët arritjen e</p>

<sup>56</sup> EFPPA (2009). EuroPsy European Certificate in Psychology EFPA Regulations on EuroPsy and Appendices, 30-33.

	<p>kërkesave minimale në edukim për ushtrimin e pavarur të profesionit të psikologut.</p> <p>Përsa i përket raportit teori/praktikë për lëndët përkatëse vlerësohet të jetë konform ligjeve në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nëse i referohemi veprimtarive formuese dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik, parimisht të lejon mundësinë për transferim kreditesh, mobilitetit, pasi janë konform udhëzimeve të MARS, por licensim dhe punësimi jo për të gjitha profilet e programit të studimit mund të jetë i mundur, i referohem këtu për shembull një diplome bachelor në Psikologji me profil Marketing apo Marrëdhënie me publikun. Mobiliteti i studentëve përmes projekteve Erasmus + është një indikator pozitiv për këtë program studimi, por mbetet për t'u parë nëse ky proces me riorganizimin e ri me profile do të ketë ecuri normale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Politikat e institucionit përcakton si kusht për pedagogët përditësimin e lëndëve dhe moduleve me literaturë të pesë viteve të fundit. Kjo gjë na u konfirmua edhe në takimin që realizuam me përgjegjësin e njësisë kryesore dhe bazë si edhe nga grupi i vlersimit të brendshëm dhe takimi me pedagogët. Për këtë aspekt për këtë vit akademik nuk na u prezantua ndonjë procedurë në lidhje me blerje tekstesh nga ndonjëri prej pedagogëve të angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit bachelor në psikologji me 5 profile. Dhe nga informacionet që morëm në bibliotekë rezultoi se nuk kishte asnjë kërkesë për blerjen e teksteve për programin e studimit Bachelor në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Menaxhim i organizatave, e. Marketing.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të lëndëve shihet si pikë delikate e këtij programi studimi duke iu referuar gamës së gjerë të profileve me të cilat është ngarkuar pa një lidhje të drejtpërdrejt me fushën e studimit sic janë psh profilet Marrëdhënie publike e Marketing, të cilat e largojnë shumë nga fusha e psikologjisë. Kompetencat, dijet dhe aftësitë e marra nga këto drejtime janë të vështira të aplikohen në profilin e punës së psikologut. Mënyra sesi orientohet drejt multidisiplinaritetit mund të çënojë njohuritë e përgjithshme bazë dhe atyre karakterizuese, me të cilat duhet të pajiset studentit i psikologjisë në ciklin e parë të studimit, gjë e cila synon ti lehtësojë më vonë përzgjedhjen e profilit të tij brenda fushës së psikologjisë.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit dhe emërtimi i diplomës për një pjesë të profileve janë në linjë me programet e tjera të fushës së psikologjisë si brenda dhe jashtë vendit, dhe këtu i referohemi Bachelor në "Psikologji", me profile: Shëndet mendor, Psikologji edukimi, Menaxhim i organizatave, ky i fundit është brenda fushës së psikologjisë organizacionale, duke u dhënë mundësinë studentëve që mbarojnë ciklin e parë të studimit të vazhdojnë më tej në nivelin master brenda apo jashtë vendit.</p>

<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Duke qenë se ky program studimi është ripërshtatur kohët e fundi mbetet për t'u parë ecuria e tij dhe sa do të konsolidohet si një program i profilizuar, gjë e cila nuk ndeshet shpesh në kurrikulën e programeve të ciklit të parë të studimeve si brenda dhe jashtë vendit. Përgjithsisht programet e ciklit të parë të studimit ndeshen nën termin "Bachelor në Psikologji" ose emërtimin me një profil apo dy të përafërta, por me 5 profile mbetet e vështirë të kuptohet, aq më tepër kur disa profile devijojnë shumë nga disiplina e psikologjisë, psh profile Marrëdhënie publike e Marketing. Përsa i përket kërkesave të tregut të punës vështirësia do të qëndrojë pikërisht në rolin që organizatat e ndryshme si psh Urdhri i Psikologut mund të kishte në drejtim të licensimit për dy profilet Marrëdhënie publike e Marketing.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
		<p><b>X</b></p>		

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Duke iu referuar të dhënave që kemi mbi edukimin dhe kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të thuhet se përgjithsisht përbushen standartet referuar titujve dhe gradave, edhe pse sugjerohet të kihen parasysh vijimësia e arsimimit të tyre brenda fushës së psikologjisë, pasi ndërthurje me pedagogjinë, punën sociale, shkencat politike, gazetarinë si grada e tituj vështirë të justifikojë mbulimin e lëndëve karakterizuese të programit, nuk do të kushtëzonin përbushjen e kërkesave ligjore dhe kualifikimit profesional për të ushtruar profesionin e psikologut, dhe as për të zhvilluar kompetenca profesionale të studentëve të këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2019-2020 na është vënë në dispozicion dhe referuar realizimit të këtij programi studimi kryesisht kanë kualifikimin e duhur dhe ka një përputhje mes angazhimit në mbulimin e moduleve mësimore të përafërta me fushën e tyre të kualifikimit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një përzierje ose në disa raste është i profilit të përafërta me psikologjinë, duke rrezikuar lehtësisht mos zotërimin e njohurive të mjaftueshme në drejtim të njohjes së thelluar të fushës së psikologjisë.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Duke iu referuar angazhimit të stafit akademik në procesin mësimor për vitin akademik aktual 2019-2020<sup>57</sup>, rezultojnë një sërë lëvizjesh që janë bërë në momentet e fundit. Përgjithësisht të dhëna mbi kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në realizimin e planit mësimor janë brenda kriterëve dhe ligjeve në fuqi. Departamenti duhet të marrë në konsideratë mundësinë e përzgjedhjes së stafit me profil të pastër<sup>58</sup> dhe kualifikime për të gjitha ciklet e studimit në psikologji<sup>59</sup>. Kusht i domosdoshëm për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës, në mënyrë që të kenë asete për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi. Eksperienca në mësimdhënie dhe kontributi në kërkimin shkencorë përmes krijimtarisë personale, publikimit të artikujve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjes në konferenca e simpoziume shkencore, duhen t'u jepet rëndësia e duhur nga njësia bazë gjatë fazës së përzgjedhjes së stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga UET rezulton se institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi<sup>60</sup> me partner dhe institucione vendase<sup>61</sup> dhe të huaja. Shqetësimi që ngrihet në këtë pikë lidhet me faktin nëse këto marrëveshje shfrytëzohen siç duhet në drejtim të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së praktikave profesionale për këtë program studimi. Praktikisht institucioni kufizon mundësinë e përfitimit të studentit nga praktika duke e realizuar modulën vetëm në auditor. Zëvendësimi i veprimtarisë së praktikës në terrenin e punës me biseda me një përfaqësues të fushës, të cilët duhet të paraqesin realitetin e profilit të punës së psikologut në atë kontekst profesional, mbështetur vetëm në përvojën subjektive të një individi shihet si kufizim në drejtim të njohjes së thellë të atij profile pune.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në natyrën specifike të programit të studimit mund të konsiderohet e përshtatshme Qendra e Shërbimeve Psikologjike, e cila, sipas informacionit të marrë në institucion, ishte mbyllur. Si pjesë e departamentit të Psikologjisë, njësia kryesore e këtij programi studimi, si pjesë e institucionit kishte aktive grupe kërkimore<sup>62</sup> të angazhuar në projekte në funksion të avancimit në drejtim të kërkimit shkencor<sup>63</sup>. Në funksion të këtij programi janë laboratorët e informatikës në mbështetje të realizimit të lëndëve specifike, por edhe salla leksioni e seminari të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për mbarvajtjen e procesit mësimor<sup>64</sup>.</p>

<sup>57</sup> Dokumenti 6 vizita në institucion. Vendimi i komisionit për përzgjedhjen.

<sup>58</sup> Dokumenti 150. CV R.(L.)K..

<sup>59</sup> Dokumenti 7 vizita në institucion. Cv E.M.

<sup>60</sup> Dokumenti 52. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. .

<sup>61</sup> Dokumenti 53. Raporti periodik I përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.


<sup>62</sup> Dokumenti 5. Strategjia e kërkimit shkencor UET 2017-2020.

<sup>63</sup> Dokumenti 4. Plani strategjik 2015-2020.

<sup>64</sup> Dokumenti 61. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të përmirësimit të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative<sup>65</sup> të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve sistemin UET LMS, i cili mundëson stafit akademik<sup>66</sup> dhe studentëve<sup>67</sup> të shkëmbejnë material dhe informacione në funksion të procesit mësimor. Ky informacion u mundësua nga shumë burime dhe dokumente të ndryshme të vëna në dispozicion.</p> <p>Institucioni ka realizuar trajnime për stafin për rifreskimin e njohurive për përdorimin e sistemit LMS, gjithashtu Vendimi për emërimin e kordinatorit të programit të studimit<sup>68</sup>, formati për monitorimin e silabuseve<sup>69</sup>, dokumenti mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës<sup>70</sup>, janë struktura që synojnë trajnimin dhe monitorimin në përmirësimin e metodave inovative në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik njësia bazë ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë<sup>71</sup>, i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Plani i veprimit KSBC- 2018-2019<sup>72</sup>; Manuali për sigurimin e brendshëm të Cilësisë<sup>73</sup> dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë<sup>74</sup>. Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor në UET.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët<sup>75</sup>, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angjhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit.</p>

<sup>65</sup> Dokumenti 178. Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS.

<sup>66</sup> Dokumenti 179. Guidë për pedagogun.

<sup>67</sup> Dokumenti 180. Guidë për studentët.

<sup>68</sup> Dokumenti 13 vizita në institucion. Vendimi për emërimin e kordinatorëve të programit.

<sup>69</sup> Dokumenti 55. Formatit I relacionit për monitorimin e silabuseve.

<sup>70</sup> Dokumenti 57. Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.

<sup>71</sup> Dokumenti 157. Urdhër administrative mbi përbërjen e KSBC.

<sup>72</sup> Dokumenti 154. Plani i veprimit KSBC- 2018-2019.

<sup>73</sup> Dokumenti 155. Manuali për sigurimin e brendshëm të Cilësisë.

<sup>74</sup> Dokumenti 156. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022.

<sup>75</sup> Dokumenti 58. Formatit I vlerësimit të pedagogut nga studentët.

	<p>Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve. Sipas informacionit të marrë nga studentët në takimin me ta, kjo formë nuk shihet prej tyre si shumë efiçente, pasi nuk ndihen komod në shprehjen e opinioneve, kjo formë vlerësimi ishte realizuar një herë gjatë vitit akademik 2018-2019. Gjithashtu, studentët kanë në dispozicion formularin<sup>76</sup> për ankesat, përmes të cilit mund të adresojnë shqetësime të çdo natyre në strukturat përgjegjëse.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësimet periodike të ndërmarra nga institucioni pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore. Edhe pse strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë po përballen me sfida të mëdha pas riorganizimit dhe hapjes së programeve të reja duke hasur vështirësi në drejtim të fushave të reja, me të cilat iu mungon përvoja, domosdoshmëria e trajnimit të stafit lidhur me njohjen dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, numri i reduktuar i punonjësve që drejtojnë zyrën e kurrikulës dhe cilësisë, janë problematika që kanë nevojë të adresohen shpejt nga ana e institucionit. I referohemi shqetësimit të shprehur nga vetë punonjësit e kësaj zyre<sup>77</sup> për sa paraqitet më sipër.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni në drejtim të inkurajimit të personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie përveç kërkesës për përditësim të silabusit me literaturë të 5 viteve të fundit, mobilitetit jashtë vendit nëpërmjet Erasmus +, përfshirjen në projekte kërkimore, aplikon edhe grante shpërblyese për pedagogët që publikojnë në revista me faktor impakti. Këto aspekte shihen si forma pozitive në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së personelit akademik për avancim në karrierën e tyre profesionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.2</b>  <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike,</p>	<p>Nga bisedat me stafin akademik të brendshëm e të jashtëm, takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive<sup>78</sup>, në funksion të një të</p>

<sup>76</sup> Dokumenti 59. Formular për ankesat e studentëve. – Departamenti.

<sup>77</sup> Dokumenti 2 vizita në institucion. Minutat e takimeve – Bsc Psikologji 5 profile, fq 24-26.

<sup>78</sup> Dokumenti 9. Rregullore mesimore e programit Ba Psikologji.

<p>orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, punimet e diplomës, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse si leksionet e hapura<sup>79</sup> me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore<sup>80</sup> gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit LMS nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga dokumentet e vëna në dispozicion mësohet se institucioni ka ndërtuar një protokoll<sup>81</sup> që i shërben pedagogut për përmirësimin e literaturës<sup>82</sup> për lëndën që mbulon. Por nuk vihen re rezultate të ndonjë avancimi në drejtim të shfrytëzimit të mundësive për blerjen dhe përshtatjen e teksteve të mira për fushën e studimit. Nuk rezulton ndonjë nismë që na u vu në dispozicion<sup>83</sup>, që të jetë ndërmarrë nga ndonjë pedagog i profilit të psikologjisë për këto dy vitet e fundit, kjo referuar informacionit të marrë në bibliotekë dhe nga takimi i zhvilluar me stafin akademik.</p> <p>Gjithsesi, institucioni ka praktika të mira përsa i përket lehtësimit të mobilitetit të stafit në mësimdhënie jashtë vendit<sup>84</sup> duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kompetencave profesionale nga ky shkëmbim në mësimdhënie në universitetet e huaja.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie duke iu referuar silabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme krijojnë kushte për një të nxënë efektiv, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik efektiv dhe ke kontratë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në</p>	<p>Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së kurrikulës dhe cilësisë për përditësimin e literaturës, ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces të ndërmarrë nga pedagogu i lëndës në mënyrë</p>

<sup>79</sup> Dokumenti 51. Takim me presidenten e urdhrat të psikologut.

<sup>80</sup> Dokumentat 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200. Ditët e studimeve Shqiptare 2019, 2018, 2017, 2016, 2015, 2014.

<sup>81</sup> Dokumenti 60. Formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik.

<sup>82</sup> Dokumenti 72. Formularë për pasurimin e literaturës në bibliotekë.

<sup>83</sup> Dokumenti 2 vizita në institucion. Minutat e takimeve – Bsc Psikologji 5 profile, fq 16-18 ; 20-21.

<sup>84</sup> Dokumenti 65. Të dhënat mbi shkëmbimin e stafit.



këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	individuale nuk ka ndonjë evidencë në dokumentacionin që kemi në dispozicion dhe as ndonjë informacion të mund të kishim marrë gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët.		
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Nga vlersimi i mënyrës sesi janë hartuar silabuset ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie, duke e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma i përshatën shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksionit por duke specifikuar se i referoheshin pedagogëve të mëparshëm që u kishin dhënë mësime, ndërsa - për prurjet e reja në departament - siç u shprehën studentët, nuk e dinë sesi do të jenë.		
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësime të ndërtimit të marrëdhënies të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret <sup>85</sup> dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, respektohet dinjiteti dhe integriteti i çdo studentit. Procesi i mësimdhënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme <sup>86</sup> për realizimin e procesit mësimor në tre godina, në një sipërfaqje prej 11.500m <sup>2</sup> , salla leksion 10, me kapaciteti rreth 1515 vende. Sallat e seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë gjithsej 14 me 35 vende secila. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim.
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimorë, si videoprojektor, por duhet riparë mundësia që sallat e leksionit të pajisen me foni, pasi duke iu referuar shqetësimit të studentëve sallat e leksionit, të cilat janë me kapacitet të

<sup>85</sup> Dokumenti 7. Rregullore UET.

<sup>86</sup> Dokumenti 61. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit.

	madh, nuk mbulohen me foni dhe si rezultat studentët që janë nga rreshtat e fundit, nuk e dëgjojnë pedagogun gjatë lektrimit.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, bibliotekën online në Sage dhe Ebsco. Sistemi moodle (UET LMS) bën të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, studenti mund të shikojë notat dhe pikët on-line. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila mund të aksesohet në bibliotekën e UET duket e kufizuar në tituj dhe cilësi të botimit <sup>87</sup> (shumë tekste të psikologjisë janë përkthyer keq dhe paraqesin një konfuzion përsa i përket terminologjisë së fushës). Literatura e përkthyer në shqip dhe e përdorur për nevojat e zhvillimit të lëndëve mësimore është botimi i para 10 deri 15 viteve. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online EBSCO & SAGE.
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Përsa i përket botimeve në dispozicion të drejtimeve kryesore të programit të studimit sipas të dhënave të bibliotekës dhe informacionit të shpërndarë nëpër dokumentet kemi një listë prej 207 tekstesh në fushëm e psikologjisë, prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010, ndërsa ato pak tekste dhe artikuj të viteve të fundit janë punime doktorature dhe artikuj shkencorë. Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj kryesisht botime të viteve 2001-2010. Nuk kemi mjaftueshëm evidenca të vëna në dispozicion nga institucioni për të gjykuar mbi cilësinë e literaturës së detyruar që duhet të përditësohet nga pedagogu dhe që duhet ishte e pesë viteve të fundit, (siç deklarohet nga përgjegjësi i njësisë kryesore dhe bazë apo nga zëvendës Rektoria për Kërkimin Shkencorë Prof. Dr. D.K.), kjo pasi nga shqyrtimi i literaturës në bibliotekë nuk përputhet me kërkesën e institucionit në drejtim të teksteve mësimore. Kërkesës tonë për të parë një procedurë për marrjen e teksteve të reja për këtë vit akademik nuk i vu në dispozicion ndonjë informacion apo material as nga biblioteka dhe njësisia bazë. Megjithatë pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushëm e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët, por këtij aspekti i shërben edhe biblioteka online EBSCO & Sage.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e	Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të EBSCO dhe Sage, gjithashtu mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë elektronike të fushës së psikologjisë në gjuhë të huaj që vihehin në dispozicion të stafit dhe

<sup>87</sup> Dokumenti 3 vizita në institucion. Lista e teksteve në bibliotekë – Psikologji.

studimit.	studentëve të programit të studimit. Nuk u pa ndonjë abonim në revista të fushës së psikologjisë në bibliotekë. Biblioteka e UET ishte pjesë e sistemit COBISS Net (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), ku janë të përfshira vendet e rajonit të Europës Juglindore.			
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Infrastruktura <sup>88</sup> në mbështetje të zhvillimit të detyrave të ndryshme nga student ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në një sër formash ndërveprimi, si mbulimi i ambjenteve të UET-it me Wi-Fi, biblioteka e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode për të punuar me literaturën, kompjuter në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Cobiss, Ebsco, Sage.			
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni ka një sistem të tijin teknologjik që e përdor për procesin mësimor, duke lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin e studentit me stafin akademik dhe studentët e tjera. MOODLE (UET LMS), është një sistem që i mundëson studentit në kohë reale të përditësohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Përmes këtij sistemi studenti mund të komunikojë në forume të hapura me pedagogët e kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët on-line.			
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Përsa i përket përdorimit të hapësirës vetjake dedikuar stafit dhe studentëve mund t'i refrohemi sistemit LMS, ku secili prej përdoruesve regjistrohet dhe në vijim akseson në sistem në çdo kohë dhe vend duke u informuar në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme etj. Ky sistem i brendshëm komunikimi shihet si tepër efektiv në drejtim të rrijës së aksesit në burimet e brendshme të informacionit si nga ana e stafit dhe e studentëve.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga institucioni në lidhje me orientimin, asistimin dhe mbështetjen nga ana e personelit akademik për studentët gjatë fazës së diplomimit <sup>89</sup> , UET ka një strukturë të mirë organizuar, e cila i krijon kushtet e nevojshme studentit në përmbylljen me sukses të kësaj faze. Kjo realizohet konkretisht nga Departamenti, i cili paraqet studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, më pas student plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kriterëve specifike, gjithashtu, në vijim janë të detyrueshme për studentin seancat metodologjike me udhëheqësin e tij.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<sup>88</sup> Dokumenti 70. Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës.

<sup>89</sup> Dokumenti 15. Dokumenti B. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimin të vazhdueshëm në mësimdhënie. Përmes Zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit<sup>90</sup>, Komisionit të Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë<sup>91</sup>, Kordinatorit të programit të studimit<sup>92</sup>, Zyrës së kurrikulës<sup>93</sup>. Puna e këtyre strukturave synon monitormin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Roli i departamentit në drejtim të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie shfaqet përbushës nevojash në drejtim të përzgjedhjes e angazhimit të personelit akademik në mësimdhënie. Përsa i përket këtij kriteri konstatohen disa paqartësi që lidhen me kualifikimin e stafit të angazhuar në këtë program studimi<sup>94</sup>, mungesë e cikleve të studimit brenda fushës së psikologjisë.</p> <p>Konstatimet tona lidhur me stafin e angazhuar këtë vit akademik mbështetur në të dhënat që na janë vënë në dispozicion mbi kualifikimin dhe përfshirjen në veprimtari kërkimore shkencore, sugjerojnë një nxitje të përfshirjes më të madhe të stafit në drejtim të avancimit në kërkim shkencor<sup>95</sup> përmes publikimit të artikujve shkencorë në revista prestigjioze të fushës së psikologjisë dhe pjesëmarrjes në konferenca apo veprimtari të tjera krijuese, në mënyrë që të rriten aftësitë profesionale edhe në drejtim të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën Polis, shfrytëzimit të bibliotekës online.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Përfshirja e stafit akademik përmes Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve përmes fondeve dhe granteve ndërkombëtare të Komisionit European<sup>96</sup>, Erasmus + etj nxisin dhe përmirësojnë aftësitë në vazhdmësi në drejtim të avancimit në kërkimin shkencor, duke ndikuar kështu edhe në rritjen e kompetencave në fushën e tyre të ekspertizës dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Trajnimi i stafit, shkëmbimi i stafit si dhe pjesëmarrja në rrjete ndërkombëtare të</p>

<sup>90</sup> Dokumenti 20. Dokumenti mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.

<sup>91</sup> Dokumenti 156. Manuali për sigurimin e brendëshëm të cilësisë.

<sup>92</sup> Dokumenti 13, vizita në institucion. Vendimi për emërimin e kordinatorëve të programit.

<sup>93</sup> Dokumenti 23. Dokumenti Mbi funksionimin e zyrës së Kurrikulës.

<sup>94</sup> Dokument 30,31, 35,26, 33,34, vizita në institucion. E.M.,I.M., D.Xh., B.L., R.B., R.K.

<sup>95</sup> Dokument 30,31, 35,26, vizita në institucion. E.M.,I.M., D.Xh., B.L.,

<sup>96</sup> Dokumenti 66. Projekte UET 2011-2018.

	<p>kërkimit shkencor është një tjetër mënyrë e cila i lejon stafit të avancojë në drejtim të mësimdhënies e kërkimit shkencor. Vënia në dispozicion të stafit akademik të një fondi kërkimor, tek i cili kërkuesit mund të aplikojnë për mbështetje për ndërmarrjen e projekteve kërkimore ose për shpërblim pas publikimit në revista dhe libra të botuara nga shtëpi botuese me reputacion ndërkombëtar, mbështet këtë proces.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në lidhje me trajnimet përsa i përket personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja mund të përmendim trajnimin për përdorimin e Sistemit LMS, referuar edhe Strategjisë së Kërkimit Shkencorë në UET 2017-2020, Qendra e Metodologjisë dhe Kërkimit mund të ofrojë trajnime 1-ditore ose me gjatë (professional development and research) për të rritur aftësitë e stafit akademik për të ndërmarrë punë kërkimore të pavarur që të jetë e botueshme në revista shkencore me faktor impakti. Trajnimet kryesisht janë të ndarë në katër grupe: (1) Trajnime për Doktorantë; (2) Trajnime për Junior Researchers; (3) Trajnime për Senior Researchers; (4) Trajnime Metodologjike. Për sa më sipër nuk kemi evidence të qarta për mënyrën sesi implementohet kjo strategji realisht.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli i angazhuar në këtë program studimi kërkon të përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kualifikimin dhe fushën e ekspertizës që zotërojnë dhe përputhjes me lëndët apo modulet që mbulojnë<sup>97</sup>, duke e vënë theksin jo vetëm te vijimësia në tre cikle studimi brenda fushës, por edhe në kualifikime të tjera profesionale që përkojnë me lëndën që mbulojnë. Referuar evidencave të vëna në dispozicion ky kriter nevojitet të shihet në vijimësi, kjo pasi një pjesë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi rezultojnë pa përvojë në mësimdhënie<sup>98</sup>, pa një linjë të pastër të kualifikimit në fushën e psikologjisë<sup>99</sup>.</p>				
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidence të qarta përsa i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori/kolegu<sup>100</sup>, dhe formulari i vetvlerësimit të performancës<sup>101</sup>, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.</p>				
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="528 1637 687 1711">Nuk përbushet</td> <td data-bbox="687 1637 911 1711">Përbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="911 1637 1134 1711">Përbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1134 1637 1364 1711">Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

<sup>97</sup> Dokument 24, vizita në institucion. A.H.

<sup>98</sup> Dokument 33,34, vizita në institucion. R.B., R.K.

<sup>99</sup> Dokument 30,31, 35,26, vizita në institucion. E.M.,I.M., D.Xh., B.L.

<sup>100</sup> Dokumenti 161. Formulari i vlersimit të pedagogut nga eprori/kolegu

<sup>101</sup> Dokumenti 60. Formulari i vetvlersimit të performancës së personelit akademik.

			<b>X</b>	
--	--	--	----------	--

**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit <sup>102</sup> të studimit, sistemin e vlerësimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar, urdhrin për vlerësimin e studentëve me aftësi shikimi të kufizuar, mbi punimin e diplomës dhe disertacionit. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin LMS.
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion gjendet lehtësisht nga studenti në çdo kohë në sisemin LMS.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit.
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet
	Përbushet pjesërisht
	Përbushet kryesisht
	Përbushet plotësisht
	<b>X</b>

**Standardi III.6**  
**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në procedurën e titulluar “Sistemi i vlerësimit të Studentëve” <sup>103</sup> , vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një

<sup>102</sup> Dokumenti 9. Rregullore mësimore e programit Ba Psikologji.

<sup>103</sup> Dokumenti 10. Dokumenti A. IV. Sistemi i vlerësimit të studentëve.

	<p>vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar<sup>104</sup>, Riprovimi, Përmirësimi, Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar<sup>105</sup> për programin e studimit. Nuk kemi evidence për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik, por ekziston një strukturë e mirëorganizuar përmes sistemit LMS për paraqitjen e vlerësimit të studentëve në të gjitha aspektet e përmendura më sipër.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit<sup>106</sup> nga pedagogu i lëndës. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i Grupit mësimor përkatës, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikat profesionale, provimi i përgjithshëm përfundimtar, dhe mbrojtja e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e koordinatores së departamentit<sup>107</sup> që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga Drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatit e çdo studenti. Çsekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidence për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidence për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por ka</p>

<sup>104</sup> Dokumenti 11. Formati I tëzës së provimit përfundimtar.

<sup>105</sup> Dokumenti 17. Formati I tëzës së provimit të përgjithshëm përfundimtarë.

<sup>106</sup> Dokumenti 10. Sistemi i vlerësimit të studentëve.

<sup>107</sup> Dokumenti 14. Dokumenti E.I. Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.

<p>shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>procedura të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënit. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezën origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave që lidhen me kushtet si mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mirat për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli. Studenti gëzon të drejtën të konsultojë tezën e provimit të sezonit paraardhës. Edhe pse gjatë takimit me studentët e programit u paraqit shqetësimi se “nga departamenti nuk kishte rregulla të forta për ata student që nuk frekuentojë dhe lejohen të hyjnë në provim dhe kopjojnë dhe marrin nota më të mira”.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë përse i përket gjithë procesi që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Duke u bazuar te rregullorja e UET, por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve<sup>108</sup> ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht <b>X</b></p>

**Standardi III.7  
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke**

<sup>108</sup> Dokumenti 10. Dokumenti A. IV. Sistemi i vlersimit të studentëve.



<b>dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit <sup>109</sup> i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë profilesh në kontekstin e shkencave shoqërore <sup>110</sup> , por kjo larmishmëri mund të shihet edhe si pengues në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën dhe në një paaftësi për të zhvilluar kompetenca profesionale te studenti përta i përket një profili të pastër psikologjik.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).	Institucioni dhe ky program studimi krijojnë të gjitha kushtet që studenti të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si në aspektin teorik përmes lëndëve që janë pjesë e kurrikulës për këtë program studimi, por edhe praktikisht përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin LMS dhe sitimin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sër aktivitetesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim si angazhimi i stafit bashkë me studentët në klubet e ndryshme <sup>111</sup> , si psh klubi Freud i psikologjisë dhe aktivitetet ekstra kurrikulare <sup>112</sup> ku janë përfshirë studentët si veprimtari bamirësie <sup>113</sup> , konferenca dhe leksione të hapura që u japin mundësi ndërveprimit.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në këtë drejtim kemi nismën e njësisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës <sup>114</sup> , ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen. Kontrolli i Brendshëm i Cilësisë ka organizuar montorimin me tematikë “Mbarëvajtja e provimeve të ndërmjetme/përfundimtare <sup>115</sup> , cilësia e korrigjimit të tyre për nivelet BA, MP, MSh”. Prezenca e këtyre praktikave në institucion shihet si element pozitiv në drejtim të përpjekjeve për të ofruar lëndë e module që synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në lidhje me aplikimin e këtij standarti kemi mungesë evidencash për të nxjerr konkluzione. Referuar lëndëve e moduleve, të cilat janë riorganizuar dhe stafit të ri të angazhuar. Por pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik	Në këtë drejtim institucioni ka praktika të mira përta i përket

<sup>109</sup> Dokumenti 25. Ba Psikologji – Plani mësimorë

<sup>110</sup> Dokumenti 28. Objektivat formuese dhe mundësitë e punësimit Ba Psikologji.

<sup>111</sup> Dokumenti 49. Klubi Freud- psikologjisë.

<sup>112</sup> Dokumenti 47. Eksperimenti social. Sa empatik janë shqiptarët.

<sup>113</sup> Dokumenti 170. Fundjava ndryshe.

<sup>114</sup> Dokumenti 56. Analiza e departamentit Ba Psikologji.

<sup>115</sup> Dokumenti 158. Metodologjia e punës e KSBC- Provimet.

<p>realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>hapësirave që kanë studentët për të përfituar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët është i angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash<sup>116</sup> ka pak evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë. Gjithsesi, vlerësohet që kjo gjë të kapërcehet nëse stafi akademik është i pandryshueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Ky kriter bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve të lëndëve/moduleve<sup>117</sup> por edhe bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, duket se përmbushet plotësisht. Pasi mësimdhënia bazohet në diskutimet e ndryshme, nxitjen e mendimin kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentit në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxënit në tërësi.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Ky element duhet parë në vijimësi, pasi personeli akademik në pjesën më të madhe është i ri, mënyra sesi do impletojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Kjo duke iu referuar përvojës së pakët në drejtim të avancimit të tyre në kërkimin shkencor dhe krijimtarinë personale të kufizuar në publikime e pjesëmarrje në veprimtari kërkimore shkencore.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Bazuar në përfshirjen në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca nuk kemi asnjë evidencë<sup>118</sup> që të na tregojë përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi. Argumenti i institucionit në lidhje me këtë kufizim që u bëhet studentëve të këtij programi studimi lidhet me faktin e mungesës së përvojës dhe mungesë në njohuri të thelluara profesionale në fushën e kërkimit shkencor. Për vitin 2018-2019, nuk rezulton të kemi raste të studentëve të programit, që të jenë përfshirë në veprimtari të tilla.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e</p>	<p>Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nismën me Urdhrin e Psikologut, mbi kriteret dhe kushtet e licensimit të psikologëve, dhe mobiliteti i stafit dhe studentëve të këtij programi shihet si pozitiv, por është herët për të</p>

<sup>116</sup> Dokumenti 24 vizita në institucion. A.H.

<sup>117</sup> Dokumenti 57. Dokumenti A. Mbi Parimet e ndërtimit të programit të lëndës.

<sup>118</sup> Dokumenti 10 vizita në institucion. Sqarim në lidhje me dokumentacionin shtesë të kërkuar sipas pikave 11, 12, 13.

studentëve.	vlerësuar vijimësinë e tij pas riorganizimit.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>X</b>	

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit bachelor dhe mbi dokumentat: Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit si dhe Formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar, institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët japin provimin final <sup>119</sup> , ose mbrojnë diplomën <sup>120</sup> . Kriteret për mbrojtje diploma me temë për programin Bachelor, me kërkesë të studentit dhe me notë mesatare së paku 8.5. Njësia bazë ka një format të posacëm për provimi të përgjithshëm përfundimtar (PPP).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Përsa i përket dy opsioneve që kanë studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimi janë provimi i përgjithshëm përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës me temë. Bazuar në formatin e njësisë bazë, kemi një ndajre të grup pyetjeve për lëndët sipas kategorive, dhe studentët orientohen paraprakisht në lidhje me literaturën që duhet të studiojnë për tu përgatitur për provimin final. Ndërsa mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seanceve metodologjike që janë të detyrueshme nga student për t'u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posacëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e provimit final komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh, për lëndë të kategorisë A(20 pikë), lëndë të kategorisë B (70 pikë), grupi i lëndëve të kategorisë C (10 pikë). Në secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh nga 10 deri në 15 pyetje. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për	Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe

<sup>119</sup> Dokumenti 17. Formai i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar (BA).

<sup>120</sup> Dokumenti 15. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.

<p>përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtarë duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndën e tyre. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësi bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave metodologjike përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jasht institucionit, ai ka nënshkruar një sër marrëveshesh bashkëpunimi. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si seancat metodologjike, konsultat me pedagogët, aksesit në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës përmes seancave metodologjike i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. Një sistem që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe lufton plagjiaturën do e lehtësonte mjaft këtë proces.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit të përgjithshëm dhe punimit të diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ky program studimi është ripërshtatur dhe institucioni ka aplikuar pranë Q.SH.A. –së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Modeli i diplomës është njësoj për të gjitha profilet pa bërë ndarjen sipas profileve të veçantë, pikërisht arsya për të cilën edhe është riorganizuar ky program studimi, dhe që promovohet si arritje e këtij programi nga drejtuesit e institucionit. Kjo formë e paraqitjes së diplomës duket se ofron paqartësi në dokumentacionin që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ndërsa përsa i përket aneksit të listës së notave sipas profileve të këtij programi studimi, paraqitja është bërë duke repektuar ndarjen sipas profileve. Rekomandohet që institucioni të tregohet korrekt dhe të respektojë të drejtat e studentit përsa i përket transparencës në përcaktimin e qartë të dy dokumentave që vërtetojnë kualifikimin e kryer nga studentët. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për riorganizim të tij nga MASR. Kjo referuar takimit me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit, të cilët e shohim profilizimin në këtë cikël studimi, si mundësi më të madhe për lexueshmërinë e diplomës në tregun e</p>

	punës..			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të silabuseve të këtij programi studimin në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Duke qenë se ky program studimi është ripërshtatur miratimi nga Q.SH.A. nuk është bërë akoma, në këto kushte kemi vakanca përsa i përket përmbylljes së procedurave.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
<b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b>	<b>Nuk përmbyllet</b>	<b>Përmbyllet pjesërisht</b>	<b>Përmbyllet kryesisht</b>	<b>Përmbyllet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbyllet</b>	<b>Përmbyllet pjesërisht</b>	<b>Përmbyllet kryesisht</b>	<b>Përmbyllet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e burimeve njerëzore <sup>121</sup> është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi. Stafit akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota. Kjo zyrë merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Kjo zyrë mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Aktualisht në strukturën e saj ka vetëm një person që mbulon shërbimin e kësaj zyre dhe njëkohësisht është dhe pjesë e personelit akademik.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një procedurë rekrutimi për personelin akademik përmes disa hapash që fillon me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e short listave për komisionin e rekrutimit, i cili merr vendimi në bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të UET janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të UET-it dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicioni si faqja e universitetit, rrjetet sociale, gazeta "Liberale", sipas të gjitha kriterëve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit <sup>122</sup> dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

<sup>121</sup> Dokumenti 18. Rregullore për burimet njerëzore.

<sup>122</sup> Dokumenti 19. Shëmbull thirrje për staf akademik.

<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni duhet të angazhohet më tepër në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuara detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Edhe pse kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Duhet parë mundësia e shtimit të stafit për disa struktura, të cilat kanë një peshë të madhe pune, sidomos pas riorganizimit dhe hapjes së programeve të reja të studimit <sup>123</sup> . Për sa më sipër, i referohemi edhe shqetësimit të sjell nga vetë punonjësit gjatë takimit me ta.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni krijon mundësi në drejtim të kualifikimit dhe rritjes profesionale nëpërmjet marrëveshjeve të shkëmbimit të stafëve dhe studentëve nga Erasmus +. Gjithashtu përmes revistës Polis u jepet mundësia të promovojnë punën kërkimore, grantet kërkimore për të cilat mund të aplikojnë pedagogët për të fituar një shpërblim prej 1250-2000 euro, në bazë të botimeve në revista me faktor impakti apo konferenca si « Ditët e studimeve Shqiptare » u jep mundësi stafit për zhvillimin e mëtejshëm profesional. Institucioni ka angazhuar stafin edhe në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Në lidhje me përdorimin e teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor institucioni bashkëpunon me stafin akademik në drejtim të rritjes së aftësive për të shkruar e botuar një punim shkencor në revista shkencore. Ofron trajnime 1 ditore përmes Qendrës së Metodologjisë dhe Kërkit, si dhe ofron trajnime për stafin në drejtim të përdorimit të sistemit LMS, kjo në kuadër të digitalizimit të procesit të mësimdhënies dhe lehtësimit të ndërveprimit të stafit me studentët për çëshjet mësimore.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni duhet të bëjë përpjekje që të krijojë kushte për tërheqjen e një personeli më të kualifikuar në profilet e shumta të tij. Burimet njerëzore të angazhuar në këtë program studimi përgjithësisht janë të mjaftueshme, por duhet bërë përpjekje në drejtim të shtimit të disa strukturave mbështetëse që lehtësojnë përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. Është e rëndësishme që të kemi një ndarje në përgjegjësi dhe detyra sipas ndarjes staf akademik dhe staf ndihmës administrative, pasi në disa raste i njëjti person mbulon njëherësh edhe punën administrative edhe atë akademike si staf i angazhuar në mësimdhënie. Ky konstatim bazohet në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, pedagogët dhe stafin

<sup>123</sup> Dokumenti 2 vizita në institucion. Minutat e takimeve –Bsc. Psikologji me 5 profile, fq 17-18.

	administrative të zyrës së burimeve njerëzore, kurrikullës dhe cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, të shpërndara në tre godina në një sipërfaqje prej 10.500 m <sup>2</sup> . Në dispozicion të mësimdhënies institucioni ka 10 salla me sipërfaqje totale 1510m <sup>2</sup> dhe 1515 vende, 14 salla seminari me sipërfaqje 45m <sup>2</sup> secila me nga 35 karrige. Janë 9 salla 70 vendesh ( leksione + seminare ) me sipërfaqje 100m <sup>2</sup> . Ky numër është i mjaftueshëm duke pasur parasysh numrin e studentëve për këtë program studimi. Grupet mësimore janë ndërtuar në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse, kjo duke respektuar edhe ndarjen në profile për këtë program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ka investuar një sistem teknologjik, i cili është në mbështetje të personelit akademik dhe studentëve në rritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit MOODLE (UET LMS). Ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjithashtu në funksion të kërkesave të ndryshme të lëndëve janë 4 laboratorë mësimorë informatike, dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwaret përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Për programet e studimit të ciklit të parë, në realizimin e lëndës Bazat e Informatikës, janë në dispozicion 4 laboratorët e Informatikës. Këto kapacitete janë në dispozicion edhe për programet e studimit të ciklit të dytë. 4 laboratorët e informatikës janë në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Parametrat e laboratorëve



	janë përkatësisht: Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m <sup>2</sup> ; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m <sup>2</sup> ; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m <sup>2</sup> ; Lab 208 B me 80 PC (laboratori i internetit) – 160m <sup>2</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Edhe pse institucioni ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. Praktikant në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, referuar takimin me personelin e institucionit (pedagogët që mbulonin praktikën, përgjegjësi i njësisë bazë, takimit me studentët) realizoheshin në auditor, kjo sipas argumentit të tyre lidhet me vështirësisë dhe barrierat që institucionet u krijojnë studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi IV.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimin, kompjuter dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Institucioni aktualisht ka në dispozicion një bibliotekë, e cila për profilin e psikologjisë ka gjithsej 207 tituj, nga të cilët një pjesë është në gjuhën shqipe dhe disa tituj në gjuhë të huaj por me vite botimi kryesisht të para 2010-së. Biblioteka e UET <sup>124</sup> është abonuar në platformën dixhitale EBSCO e SAGE si dhe COBISS.Net (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online) që është një rrjet i vendeve të rajonit të Europës Juglindore. Duke iu referuar kushteve për realizimin e një procesi mësimorë normal është e këshillueshme që fondi i librave që i përkasin fushës së psikologjisë të jetë i pasur me libra në gjuhën shqipe minimalisht për lëndët mësimore të programit të studimit. Literatura në gjuhën shqipe që disponohej në bibliotekë <sup>125</sup> është kryesisht e para viteve 2005 apo 2010, literature në gjuhë të huaj është modeste me tituj të cilët përkasin fushës së

<sup>124</sup> Dokumenti 70. Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës.

<sup>125</sup> Dokumenti 69. Libra psikologjie në bibliotekë.

	<p>psikologjisë. Institucioni duhet të bëjë përpjekje për të pasuruar me tituj në gjuhën shqipe literaturën që t'i shërbej procesit mësimorë dhe lëndëve të caktuara. Gjithashtu këshillohet që të shfrytëzojë më mirë asetet material që ka në dispozicion përmes shtëpisë botuese UET PRESS, për të blerë të drejtën e autorit dhe të përkthejë disa tekste të rëndësishme për të mbuluar lëndët karakterizuese për këtë program studimi. Institucioni duhet të bëjë përpjekje që të krijojë kushte për personelin dhe studentët që të kenë në dispozicion një literaturë të përditësuar dhe të pasur në tituj nga shtëpi botuese prestigjioze ndërkombëtare në fushën e psikologjisë, si dhe të krijojë mundësi për abonimin në një revistë shkencore ndërkombëtare me parametra cilësore, për secilin nga profilet e këtij programi studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e UET dhe për personelin e institucionit. Për t'u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe një fotografi dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Referuar dokumentave në dispozicion e kemi të vështirë të gjykojmë mbi planet e institucionit në drejtim të shtimit të zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit me 5 profile<sup>126</sup>, duke i mbuluar secilin prej profileve me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj. Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit u informuam nga personi përgjegjës se për pasurimin e saj zakonisht ndiqej një procedurë e tillë ku pedagogët marrin një formular<sup>127</sup> që e plotësojnë me titujt që duan të bëhet blerja sipas lëndëve që mbulojnë për programin e studimit, më pas formulari firmoset nga shefi i departamentit dhe Administratori (miratimi i kërkesës), dhe më pas Biblioteka vijon me porositjen dhe blerjen e tyre. Për këtë vit akademik nuk kishte ndonjë kërkesë nga stafi akademik për blerje të teksteve të reja mësimore. Këtë informacion na e konfirmon përgjegjësjë e bibliotekës, por edhe pedagogët përgjatë takimit që patëm me to.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur cdo ditë nga ora 09.00 – 20.00, por gjatë sezonit të provimeve ky orar zgjatej më shumë. Zakonisht këto orare janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, duke krijuar në këtë mënyrë kushte optimale për akses tek fondi i saj në cdo kohë që iu nevojitet. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për</p>

<sup>126</sup> Dokumenti 70. Të dhëna statistikore për fondin e bibliotekës.

<sup>127</sup> Dokumenti 72. Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë.

	shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit <sup>128</sup> është një program, i cili është në funksion të ruajtjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave të studentëve për të gjitha programet e studimit, të stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrative të institucionit. Kjo strukturë është përgjegjëse për raportet financiare të institucionit, statistikat përshkruese të buxhetit, zërat për menaxhimin e aspekteve të funksionimit të universitetit, financat e studentëve që përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave. Ky sistem elektronik shërben për administrimin e informacionit personal të studentëve dhe evidence mbi rezultatet e provimeve ndër vite. Ky sistem administrohet nga personat e zyrës së IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka në dispozicion një sistem të brendshëm të menaxhimit që quhet Moodle UET LMS. Ky sistem elektronik administrojnë materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, material shtesë, pikë dhe vlerësimet e studentëve në lëndë të ndryshme. Ai informon studentët për pikët dhe notat on-line në kohë reale. Gjithashtu, ky sistem lejon ruajtjen e dokumentacionit dhe aktivitetet e personelit akademik. Ky sistem është në funksion kryesisht të procesit të mësimdhënies.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit (UMIS) është një program, i cili është i aksesueshëm nga persona të autorizuar dhe gjithashtu mund të krijohen kushte për akses në informacione e dokumenta për studentët.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të	Sistemi UET LMS siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin;

<sup>128</sup> Dokumenti 177.Manual i përdorimit të sistemit UMIS.

informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti.			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Ky sistem menaxhimi garanton monitorimin në kohë reale të një sërë aktivitetesh që lidhen me mbarëvajtjen e procesit akademik përmes statistikave numerike të gjeneruara prej tij. Në fund të çdo semestri gjenerohen statistika përshkruese në lidhje me përdorimin e sistemit nga stafi akademik. Këto të dhëna i vihen në dispozicion përgjegjës të departamentit, organeve drejtuese dhe personave të tjerë përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit mësimor.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të UET <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organikogramën; guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, univesiteti promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi me zyrën e financës mësohet se buxheti financiar hartohet çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. H.Ç. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti përcaktohet vetëm nga administratori dhe si i tillë ai implementohet duke u orientuar nga nevojat dhe vizioni i një njeriu të vetëm. Mbetet e paqartë mënyra sesi përcaktohet mbështetja financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një

	<p>cikël të plotë studimi, referuar të dhënave ato paraqiten të plota për të gjitha programet e studimit<sup>129</sup>. Mësohet përgjithësisht se asnjë program studimi nuk ka buxhet të individualizuar. Të ardhurat kryesore për mbarëvajtjen e programit vijjnë përgjithësisht nga studentët e përfshirë në program ose edhe ndonjë projekt i fituar (specifikisht nuk na u thanë të tillë).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional nga Asambleja ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura, por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Asambleja në komunikim me departamentet vendos për caktimin e tarifës së shkollimit. Planifikimi dhe shpenzimet buxhetore bëhen në rang universiteti. Përsa i përket burimeve të të ardhurave pjesa më e madhe vjen nga tarifat e studentëve, por institucioni ka edhe të ardhura dytësore nga projekte, lëshimi i ambjenteve me qera, nga vërtetimet e studentëve, donacionet e ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. Hartimi i një raport në lidhje me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të këtë një opinion ligjor të pavarur mbi pasqyrat financiare në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parash për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në lidhje me raportin financiar për këtë program studimi evidencat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. Gjatë vizitës në institucion nga zyra e financës na u paraqit procedura që ndjek institucioni. Ai përmes departamentit studion tregun e punës<sup>130</sup>, nëse ka pritshmëri për të ardhme dhe bën një plan biznes. Nëse pritshmëritë janë të larta atëherë programi i studimit mbështetet financiarisht. Pritshmëritë sipas kësaj zyre ishin pozitive dhe ishte marrë vendimi për ta mbështetur këtë program studimi i cili kishte gjithsej 113 studentë, 23 në vitin e parë, 30 në vitin e dytë dhe 60 në vitin e tretë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë</p>	<p>Informacioni i vënë në dispozicion mbi qëndrueshmërinë financiare të institucionit dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Referuar të</p>

<sup>129</sup> Dokumenti 76. Të dhënat mbi kostot

<sup>130</sup> Dokumenti 29. Studimi periodik i tregut të punës.

<p>kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>dhënae institucioni ka asete që justifikojnë mbulimin e shpenzimeve në drejtim të zhvillimit e vazhdimësisë institucionale.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve <sup>131</sup> deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendëshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), dhe është pjesë e fushatave informuese në shkolla përmes fletëpalosjeve.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Mësohet se institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit <sup>132</sup> , për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, përsa i përket kriterëve dhe procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve <sup>133</sup> , përparimit përgjatë kursit të studimit të ciklit të parë. Në faqen zyrtare të institucionit janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente, por sugjerohet të përcaktohej tek kriteret për t'u rregjistruar në këtë program studimi edhe kriteri i notës mesatare 7.5 që është vendosur nga MASR për këtë program studimi dhe që repektohet edhe nga ky institucion i arsimit të lartë. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e UET-it mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Universiteti European i Tiranës, në përputhje me ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Senatit Nr.01, datë 06.02.2019, ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit me karakter profesional si dhe programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen

<sup>131</sup> Dokumenti 36. Të dhënat për cilësinë në hyrje dhe dalje Ba Psikologji.

<sup>132</sup> Dokumenti 39. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.

<sup>133</sup> Dokumenti 37. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve.

	zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë.			
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret specifike dhe të përgjithshme, për pranimin në programin e studimit, janë në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit nr.01, datë 06.02.2019, që ndiqen në maturën shtetërore. Pranimi i studentëve në programin Bachelor Psikologji është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik. Në vitin akademik 2019-2020 nota mesatare në hyrje ishte 7, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 është 7.5 <sup>134</sup> . Në procedurat e përcaktuara për këtë program studimi, përveç shtetasve shqiptarë, mund të regjistrohen dhe shtetas të huaj.			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit <sup>135</sup> . Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UET. Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t’u regjistruar në programin e Psikologjisë, janë të shumta si Gjimnaz tour, këshillimi në hollin e UET gjatë periudhës së regjistrimeve, etj			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese <sup>136</sup> që realizohen ditët e para <sup>137</sup> të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online UMS dhe LMS. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë koordinatores së Departamentit formularin e paradiplomimit, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë.

<sup>134</sup> Dokumenti 183. Vendimi Nr 295 datë 10.05.2019 për notën mesatare.

<sup>135</sup> Dokumenti 78. Politika e marketingut të programit të studimit.

<sup>136</sup> Dokumenti 38. Mbi Tutoriatin dhe këshillimin akademik.

<sup>137</sup> Dokumenti 20. Mbi funksionimin e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni konform ligjeve për arsimin e lartë dhe në linjë me rregulloren e tij aplikon kriteret e procedurat të njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Gjithashtu, përmes infrastrukturës në dispozicion krijon hapësirat e nevojshme që studentit të informohet për këtë aspekt.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet Java e Orientimit, e cila është e përvitshme në universitet. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UET-it. Studentët njihen me ambientet ku do të zhvillohet mësimi. Gjithashtu, gjatë javëve të regjistrimit, studentët mund të marrin informacion nga pedagogët e programeve të studimit që ata duan të ndjekin. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. Këto procedurat janë të unifikuara për të gjithë universitetin, dhe janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e ciklit të parë të studimeve në Psikologji, përgjatë fundit të semestrit të parë dhe fillimit të semestrit të dytë në lidhje me mundësitë e diplomimit përmes dy formave; Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) ose temës së diplomës. Për të mbrojtur diplomën me temë kërkohet mesatarja mbi 8.5 dhe mbetet opsionale sipas dëshirës së studentit për ta përzgjedhur ose jo këtë formë diplomimi. Departamenti vë në dispozicion të studentëve 3 pedagogë dhe ata janë të lirë të zgjedhin udhëheqësin e tyre. Institucioni përcakton rregulla për monitorimin e progresit në punimin e diplomës përmes ndjekjes me detyrim të seancave metodologjike me udhëheqësin. Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtarë dhe mbrojtjen e diplomës me temë e realizon koordinatori i Departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo pranverë UET-i organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkollat të mesme në qytete të ndryshme të vendit (<i>Gjymnaz tour</i>) për t'u bërë të njohur maturantëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje. Veprimtaritë "Open Days" që i ftojnë maturantët në vizitimin e institucionit dhe të ndjekin orë leksioni të hapura si dhe "Java e Orientimit" për studentët e vitit të parë para fillimit të vitit akademik ndihmojnë studentët të marrin informacionin e nevojshëm. Përgjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe</p>

	mundësitë e transferimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash. Duke nisur me informacionin në faqen online të UET-it, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga zyra e Kujdesit për studentët, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit. Gjithashtu duke përdorur platformën digjitale LMS studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semstrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit <sup>138</sup> , të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjithashtu, në UET funksionon Bordi i tregut të punës <sup>139</sup> , i cili shërben si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës, edhe pse referuar statistikave <sup>140</sup> në dispozicion numri i studentëve të punësuar brenda këtij profili është i papërfillshëm. Nuk kemi evidenca konkrete ku bordi i punës ka ndërmjetësuar për punësimin e studentëve të këtij programi studimi. Organizimi i panairëve të punës <sup>141</sup> dhe aktivitetëve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës si pjesë e realizimit të praktikës profesionale në auditor janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth

<sup>138</sup> Dokumenti 20. Mbi funksionimin e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit.

<sup>139</sup> Dokumenti 21. Bordi i Tregut të punës 2018-2019.

<sup>140</sup> Dokumenti 41. Të dhënat përmbledhëse për punësimin e studentëve Ba Psikologji.

<sup>141</sup> Dokumenti 22. Poster panairi i punës 2019.

	mundësive për punësimin e tyre. Duke përdorur sistemin LMS apo rrjetet sociale, institucioni dërgon njoftime punësimi te studentët, por jodomosdoshmërisht brenda fushës.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Sistemi UET LMS siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi.	Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje <sup>142</sup> . Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 6 vitet e fundit, konstatohet se numri i studentëve të diplomuar ka pësuar luhataje përgjatë viteve. Me një rënie të dukshme për vitin akademik 2019-2020, ku numri total i studentëve të regjistruar në vitin e parë është 23 studente nga 29 që ishte për vitin 2018-2019. Ndërsa nota mesatare në dalje ka pësuar një rritje nga 7.53 në hyrje në 7.99 në dalje për vitin akademik 2018-2019.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para	Referuar statistikave në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë në vitin e parë, i cili përgjatë viteve duket se ka një rënie. Referuar statistikave duket se ndarja me profile ka filluar të aplikohet duke filluar nga viti

<sup>142</sup> Dokumenti 36. Të dhëna për cilësinë në hyrje dhe në dalje Ba Psikologji.

<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi I studimeve.</p>	<p>akademik 2016-2017, i paraqitur ky dhe me numrin e studentëve të rregjistruar në secilin prej profileve. Ajo çfarë vihet re duke u bazuar tek statistikat është se ulja e numrit të studentëve të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë, duket se shkon parallel me profilet, nga 46 studentë të rregjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2016-2017 në 23 studentë të rregjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2019-2020. Duke iu referua miratimit për riorganizimin e këtij programi studimi nga MASR ajo mban datën 12.09.2018.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë 6 viteve të fundit dhe fokusohen në të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, student të transferuar sipas viteve në fashën e 6 viteve. Referuar statistikës kemi një rritje të notës mesatare në dalje për studentët e këtij programi studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra e regjistrimit të studentëve dhe sekretaria mësimore janë strukturat e posaçme që merren me ruajtje dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik UMIS. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e UET. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin UMIS për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Referuar raporti të departamentit<sup>143</sup> mbi punën e tij për vitin akademik 2018-2019 ka një qëndrim pozitiv mbi profilizimin e këtij programi dhe gjithashtu shihet si tregues pozitiv vendosja e mesatares që ndikon në prurje me cilësi edhe pse kjo njëkohësisht ka reduktuar shumë numrin e studentëve (23) që regjistrohen në këtë program studimi dhe kjo pasqyrohet më së miri në numrin e studentëve të regjistruar për vitin akademik 2019-2020. Gjithashtu, departamenti disponon evidenca mbi shkallën e punësimit të tyre dhe referuar këtyre të fundit panorama nuk shihet positive, vitin e fundit akademik 2018-2019, numri i studentëve të këtij programi studimi që janë të punësuar brenda profilit është zero, dhe argument i këtij ngërçi sipas departamentit lidhet me moslicënsimin nga urdhri, pasi nuk kanë përfunduar ciklin e dytë të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<sup>143</sup> Dokumenti 56. Analiza e departamentit Ba Psikologji

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studeentëve, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UET-it. Përfshirja e studentëve në një sër strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-it.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit siç është Klubi Freud i Psikologjisë. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes sistemit LMS dhe përmes fokus grupeve.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit nuk kemi evidencë që ato të jenë përfshirë në riorganizimin e tij. Gjatë vizitës në institucion madje studentët u shprehën se nuk e kanë mirëpritur këtë profilizim, i cili i ka bërë më konfuz, pasi akoma pa njohur mirë fushën u kërkohet të vendosin për të marrë një drejtim profesional. Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara më parë nga studenti.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to është e vështirë të evidentohet duke iu referuar edhe përvojës së freskët që UET-i realizoi së fundmi me riorganizimin e programeve të studimit. Madje, referuar këtij procesi ka një kërkesë nga ana e studentit për përmirësimin cilësor të kurrikulës së këtij programi studimi me lëndë, të cilat të kenë më shumë lidhje me fushën. Një tjetër shqetësim i tyre lidhet me faktin që shumë nga lëndët bazë zhvillohen bashkë me student të programeve të

	tjera studimi dhe informacioni është jo në përputhje me programin e studimit Bsc. Psikologji me 5 profile.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit është përgjegjëse për ndjekjen e procedurave, të cilat kanë të bëjnë me informimin dhe shërbimet për studentët. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e mbështetjes së studentit për çdo aspekt që ka të bëjë me mësimdhënien dhe orientimin drejt karrierës profesionale. Gjithashtu, një sërë shërbimesh informuese merren edhe duke përdorur sistemin LMS i cili është i aksesueshëm nga student në kohë reale.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në shërbim të studentëve janë dhe funksionojnë zyra e këshillimit të karrierës, panairët e punës, bordi i tregut të punës. Realizimi i panairit të punës për vitin 2019, ofronte mundësi të ndryshme për punësim, ku studentët kanë akses të lirë pjesëmarrjeje dhe informohen mbi tregun e punës në përputhje me degën e studimit. Megjithatë, referuar evidencave të vëna në dispozicion asnjë student nuk është punësuar në profilin e tij për vitin akademik 2018-2019. Çdo departament ka një pedagog, të cilit i është caktuar roli i Këshilluesit të Karrierës, i cili u jep njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe karrierës studentëve të këtij programi studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit	Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në UET funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të

<p>mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin<sup>144</sup> e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Referuar këtyre evidencave numri i studentëve të punësuar në profil është i papërfillshëm, ndërsa një pjesë e vogël janë punësuar jashtë profilit, dhe pjesa më e madhe është e papunë. Referuar evidencave të kësaj zyre për studentët e diplomuar në vitin akademik 2017-2018, numri total i të diplomuarve është 68 studentë, nga të cilët 2 janë punësuar në përputhje me diplomën, 5 punojnë jashtë profilit dhe 27 janë të papunë dhe pjesa tjetër 23 janë të padisponueshëm.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<sup>144</sup> Dokumenti 41. Të dhënat përmblidhëse për punësimin e studentëve Ba Psikologji.

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Institucioni ka miratur një grup pune, i cili do të drejtojë këtë strukturë <sup>145</sup> , ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme <sup>146</sup> . Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në dy dokumenta të rëndësishëm për funksionimin e saj siç janë: Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë <sup>147</sup> dhe Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë <sup>148</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka hartuar një plan veprimi <sup>149</sup> , në të cilin kurrikula do të harmonizohet me ligjet e reja për arsimin e lartë. Kjo veprimtari do të realizohet përmes vlerësimit të programeve të studimit me qëllim që të riorganizohen sipas ligjeve të reja. Departamentet do të kenë rolin kryesor në përcaktimin e përmbajtjes së programeve të studimit, puë e cila do të monitorohet në vijimësi nga zyra e kurrikulës. Aktualisht kjo zyrë mbulohej nga një person. Procesi i riorganizimit paracakton bashkëpunimin me bordin e punës dhe Alumni për gjenerimin e ideve të reja si pjesë e planit të veprimit. Gjithashtu, plani i veprimit si hap tjetër përfshin edhe monitorimin e opinionit të studentëve përmes disa formave si pyetësorët online, fokus grupet etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë process. Ascal ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrative me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e

<sup>145</sup> Dokumenti 157. Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC.

<sup>146</sup> Dokumenti 153. Të dhënat për individët e angazhuar në KSBC.

<sup>147</sup> Dokumenti 156. Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022.

<sup>148</sup> Dokumenti 155. Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

<sup>149</sup> Dokumenti 154. Plan Veprimi KSBC 2018-2019.



Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, zv. Rektorja për kërkimin shkencorë, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikqyrëse në lidhje me vlersimin e përputhshmërisë së silabuseve <sup>150</sup> e me standardet e institucionit për lëndët që zhvilloheshin në semestrin e dytë, viti akademik 2018-2019. Pas këtij procesi u përcjell departamenteve një draft raport nga ku pritet një reflektim. Ky komision ka realizuar një veprimtari mbi mbarëvajtjen e provimeve të ndërmjetme/ përfundimtare <sup>151</sup> në të dy ciklet e studimit <sup>152</sup> . Këto veprimtari dëshmojnë hapa pozitiv në drejtim të ambicjes institucionale drejt rritjes së cilësisë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Monitorimi nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit të ciklit të parë fokusohet në dy aspekte, monitorimin e mënyrës së ndërtimit të silabusit të lëndës sipas standarteve të institucionit si dhe përmes vlerësimit të procedurave të ndjekura në drejtim të mbarvajtjes së provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat përgjegjëse.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KSBC pas realizimit të procesit monitorues, harton një draft-raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni.
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,	Duke iu referuar këtij standarti kemi kufizime në dokumentacion për

<sup>150</sup> Dokumenti 160. Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset.

<sup>151</sup> Dokumenti 158. Metodologjia e punës së KSBC Provimet.

<sup>152</sup> Dokumenti 159. Format raporti për provimet.

rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	të reflektuar mbi raportin e vlerësimit. Kemi të dhëna jo të plota mbi përmbajtjen e relacionit të komisionit të brendshëm të cilësisë dërguar departamentit. Nuk mund të gjykojmë për këtë standart vetëm mbi shkresat përcjellëse dhe formatet e aplikuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm <sup>153</sup> të cilësisë është ngritur nga departamentit me qëllim hartimin e një raporti vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Të dy këto struktura përdorin metodologji korrekte në drejtim të mbledhjes së të dhënave, si shqyrtim dokumentacioni, vlerësimin e komponentëve të përcaktuar në standartet shtetërore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Format raportet, vlerësimi i dokumentacionit, vëzhgimi, intervistat gjysëm të strukturuar, focus grupet janë disa nga metodat që janë përdorur për kryerjen e vlerësimit për këtë program studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj <sup>154</sup> , si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të	Lidhur me këtë standart mësohet se institucioni realizon çdo

<sup>153</sup> Dokumenti 188. Urdhër nr.3, datë 04.03.2019 Për ngritjen e GVB.

<sup>154</sup> Dokumenti 161. Formulari i Vlersimit të pedagogu nga eprori/kolegu.

<p>vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>semestër një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti<sup>155</sup>, relacioni për monitorimin e silabuseve<sup>156</sup>, ankesat e studentëve<sup>157</sup> si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik<sup>158</sup>. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë është angazhuar në dy projekte ndërkombëtare, ENCHASE TEMPUS<sup>159</sup>, i cili ka në fokus zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së brendshme në universitet përmes përforcimit të një kuadri kombëtar të sigurimit të cilësisë sipas standardeve europiane në arsimin e lartë. Projekti synon zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve lidhur me sigurimin e cilësisë së brendshme në universitet. Dhe projekti QAinAL<sup>160</sup>, i cili ka si qëllim krijimin e zyrës në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri që synojnë sigurimin e cilësisë, ngritjen e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë, trajnime për hartimin e programeve të studimit në bazë të nevojave të tregut të punës, plane veprimi mbështetëse për proceset e sigurimit të cilësisë dhe rritjen në mësimdhënie dhe administrim si dhe modernizimin e infrastrukturës së Sigurimit të Cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e</p>	<p>KSBS përmes këtyre projekteve synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve kordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni i</p>

<sup>155</sup> Dokumenti 58. Format i vlerësimit të pedagogut nga student.

<sup>156</sup> Dokumenti 55. Format i Relacionit për monitorimin e Silabuseve

<sup>157</sup> Dokumenti 59. Formularin për Ankesat e Studentëve/ departamenti.

<sup>158</sup> Dokumenti 60. Formularin e Vetvlerësimit të Performancës së Personelit Akademik.

<sup>159</sup> Dokumenti 162. Fisha e projektit ENCHASE TEMPUS.

<sup>160</sup> Dokumenti 163. Fisha e projektit QAinAL.

<p>brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përbërë nga 6 anëtarë, të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, zv. Rektorja për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve sipas rastit dhe aktiviteteve<sup>161</sup>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtrojnë detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë<sup>162</sup>. Gjithashtu edhe përfshirja e 3 studentëve nga bachelor dhe masterat në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përbërja e GVB është e përbërë vetëm nga anëtarë të brendshëm të departamentit. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinionëve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>				

**Standardi VI.5**  
**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm</p>	<p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Politikat e</p>

<sup>161</sup> Dokumenti 163. Fisha e projektit QAINAL.

<sup>162</sup> Dokumenti 188. Urdhër për ngritjen e GVB.

<p>të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksioni të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UET-it. Në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin transparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e UET-it. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi ndër vite<sup>163</sup>, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, por këto evidenca nuk na japin mundësi të gjykojmë mbi cënimin e lirisë për të dhënat personale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit<sup>164</sup> të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit mbetet i paqartë sesi përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic mbetet e paqartë nëse ka pasur ndonjë reagim nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e UET dhe statuti, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB). Por mbeten të paqarta format sesi bashkëpunohet në drejtimtë</p>

<sup>163</sup> Raporti i vlerësimit Psikologji Ba 2011-2012. <http://uet.edu.al/nee/raporte-vleresimi/?lang=sq>

<sup>164</sup> Dokumenti 1. RVB-Bachelor –Psikologji. fq 57-58.

	<p>përmirësimin të cilësisë në programin e studimit në vijimësi të daljes së rezultateve për raportin e vlerësimit të brendshëm. Nëse ndahen dhe bëhen objekt i diskutimeve publike me palët e interesuara siç mund të jenë departamenti, stafi akademik dhe studentët e programit. Mbetet e paqartë, nëse raporti është prezantuar diku, apo është thjesht një raport që duhet të realizohet t'ju vënë në dispozicion ASCAL- it dhe grupit të vlerësimit të jashtëm të këtij programi.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Manaxhimi i organizatave dhe e. Marketing. të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti European i Tiranës"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Dixhtalizimi i sistemit të të dhënave në ndihmë të infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
2. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentëve përmes Erasmus +.
3. Përfshirja e stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit.
4. Praktika të mira, të ndërmarra nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë mbi monitorimin e silabuseve dhe provimeve.
5. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik.
6. Infrastruktura fizike në funksion të realizimit të procesit mësimor.
7. Abonimi në bibliotekën online EBSCO&SAGE dhe COBISS Net.
8. Zyra e këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit ka një rol ndihmues dhe të konsiderueshëm në drejtim të mbështetjes së studentit.

**Pikat e dobëta:**

1. Përmbajtja e programit të studimit e ngarkuar me lëndë/module, të cilat jo gjithmonë përputhen me fushën e psikologjisë.
2. Një pjesë e stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie nuk ka arsimin përkatës e kualifikimet e duhura në linjë me programin e studimit me 5 profile.
3. Ndyshimet e shpeshta të stafit akademik, të cilat vënë në rrezik qëndrueshmërinë e programit.
4. Profilizimi i programit të studimit në nivelin bachelor në 5 profile të ndryshme, ku jo të gjitha profilet kanë lidhje të drejtpërdrejtë me disiplinën e saj duke krijuar pamundësi në formësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të psikologut
5. Mungesë për të përshtatur riorganizimin e programit me nevojat e tregut të punës.
6. Mungesë për të integruar rezultatet e kërkimit në procesin mësimor.
7. Literatura e cunguar në gjuhën shqipe dhe të huaj për mbulimin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit sipas 5 profileve.



8. Tjetërsimi i mënyrës së realizimit të lëndës së Praktikës.
9. Mospërfshirja e studentëve të programit të studimit në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programit të tij.
10. Kërkesa për profilizim që në vitin e parë, e cila krijon konfuzion te studenti dhe nuk i përgjigjet nevojave dhe statusit aktual të tij për objektivitet në vendimarrje.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë nga grupi i vlerësimit të jashtëm mbështeten te pikat e forta dhe mundësitë e institucionit, për të ndërhyrë dhe përmirësuar pikat e dobëta dhe pengesat në drejtim të konsolidimit dhe zhvillimit në linjë me standartet europiane të programit të studimit "Bachelor" në "Psikologji", me profile: a. Shëndet mendor, b. Psikologji edukimi, c. Marrëdhënie publike, d. Manaxhim i organizatave dhe e. Marketing:

#### **Rekomandime**

1. Përfshirja në emërtimin e suplementit të diplomës ndarjen sipas profileve.
2. Përzgjedhja e stafit akademik me një kualifikim në psikologji dhe profil të njëjtë ose të përafërt me modulet /lëndët që mbulojnë
3. Përshtatje më e mirë e kurrikulës së programit në përputhje me tregun e punës dhe me standartet e liçensimit nga Urdhri i Psikologut.
4. Rritja e mundësive të përfshirjes së stafit akademik në kërkimin shkencor dhe integrimi i rezultateve të kërkimit në procesin mësimor.
5. Rritja e numrit të burimeve të literaturës për lëndët e programit të studimit në 5 profile, në gjuhën shqipe dhe të huaj.
6. Përfshirja e studentëve në procesin e komunikimit të rezultateve të vlerësimit të programeve të studimit, të mësimdhënies dhe vlerësimit të brendshëm.
7. Të shfrytëzohen marrëveshjet e bashkëpunimit në drejtim të praktikës profesionale.
8. Përfshirja e studentëve të programit të studimit në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim motivimin e tyre në drejtim të rritjes së përpjekjeve për avancim në rezultatet akademike dhe zhvillimin e dijeve dhe njohurive mbi fushën e studimit.
9. Riaktivizimi i qendrës së shërbimeve psikologjike, si një formë e mirë për të lehtësuar përvojat e praktikës profesionale.
10. Shfrytëzim më i mirë i të dhënave që departamenti nxjerr nga analiza e punës së pedagogut të lëndës në fund të çdo semestri.



11. Shfrytëzimi më i mirë i bashkëpunimit me bordin e punës, me qëllim mbështetjen e studentëve drejt punësimit brenda fushës së studimit.
12. Bashkëpunimi me UET Press në drejtim të blerjes së të drejtës së autorit, përkthimit të teksteve për lëndët e programit të studimit sipas profileve të reja pas riorganizimit.



**Conclusions of the evaluation of the first Bachelor study program in "Psychology", with profiles: a. Mental health, b. Educational psychology, c. Public relations, d. Management of organizations, e. Marketing, of Higher Education Institution "European University of Tirana"**

**Strengths and affirmations:**

1. Digitalization of the data system in terms of instruction in teaching and learning.
2. Promoting exchanges in higher education for academic staff and students through Erasmus +.
3. Involvement of academic staff in national and international projects of the institution.
4. Good practices initiated by the internal quality assurance commission on syllabus and exam monitoring.
5. Student involvement in periodic evaluations of teaching forms and academic staff.
6. Physical infrastructure available for realization of the teaching process.
7. Subscription to EBSCO & SAGE and COBISS Net online libraries.
8. Office of Career Counseling and Student Care has a supporting role in the students' academic life.

**Weaknesses:**

1. The content of the study program loaded with subjects/modules that does not always fit into the field of psychology.
2. Part of the academic staff, engaged in teaching, did not have the relevant education and qualifications needed in line with the 5-profile study program.
3. Frequent changes of academic staff endanger the sustainability of the program.
4. Profiling the study program at the bachelor level in 5 different profiles, where not all profiles are directly related to its discipline, make impossible to shape knowledge and develop psychologist competencies
5. Deficiency to adapt the program reorganization to the needs of the labor market.
6. Deficiency to integrate research results into the teaching process.
7. Poor literature in Albanian and foreign language to cover courses and modules of study program according to 5 profiles.
8. Alienation of the way the Course of Practice is realized.
9. Exclusion of students in the process of communicating the evaluation results of their study program.
10. Requirement for profiling in the first year, which creates confusion for the student and does not respond to his needs and current status for objectivity in decision making.

The recommendations presented below by the external evaluation team are based on the strengths and opportunities of the institution and enable intervention to improve weaknesses and threats in terms of consolidation and development in line with European standards of the Bachelor study program in "Psychology", with profiles: a. Mental health, b. Educational psychology, c. Public relations, d. Management of organizations, e. Marketing.



**Recommendations:**

1. Including in the nomination of the diploma supplement the separation for the specific profile
2. Selection of academic staff with a qualification in psychology and a profile similar or approximate to the modules/courses they cover.
3. The best adjustment of the curriculum of the program in accordance with the labor market and licensing standards from the psychology order.
4. Increasing opportunities for academic staff to be involved in research work and integrating research results into the learning process.
5. Increasing the number of literature sources for study program subjects in 5 profiles, in Albanian and foreign languages.
6. Involve students in the process of communicating the results of study, teaching and internal evaluation programs.
7. Utilization of cooperation agreements in terms of professional practice.
8. Involvement of study program students in national and international projects, with the aim of motivation to increase their efforts to achieve higher academic results and to develop knowledges in the field of study.
9. Re-activating the center of psychological services as a good way to facilitate professional practice experiences.
10. Better use of collaboration with the working group to support students in employment within their field of study.
11. Making the most of the data the department extracts from the job analysis by the lecturer at the end of each semester.
12. Collaboration with UET Press in terms of acquisition of copyright, translation of textbooks for the study program subjects according to new profiles after reorganization.

